

KOMPANIA RAJONALE UJËSJELLËSI “PRISHTINA” SH.A

Plani i Biznesit 2018-2020

Prishtinë, tetor / 2017

Përmbajtja:	
HYRJE	5
1. PROFILI I KRU “PRISHTINA” SH.A.....	6
1.1. Përshkrimi i ndërmarrjes	6
1.1.1. Historiku i ndërmarrjes	6
1.1.2. Lokacionet e KRU “Prishtina” sh.a.	7
1.1.3. Profili i konsumatorëve të KRU “Prishtina” sh.a.	9
1.1.4. Zona e Shërbimit	10
1.1.5. Burimet e ujit të KRU “PRISHTINA” sh.a.....	12
1.1.5.1. Fabrika për përpunimin e ujit në Shajkovc.....	12
1.1.5.2. Fabrika për përpunimin e ujit në Badovc	12
1.1.5.3. Fabrika për përpunimin e ujit në Shkabaj	12
1.1.5.4. Stacioni për përpunimin e ujit në Drenas.....	13
1.1.5.5. Stacionet për pompimin dhe përpunimin e ujit.....	13
1.1.5.6. Rrjeti shpërndarës i ujit të pijes.....	13
1.1.5.7. Prodhimtaria mujore në m3 për vitin 2018-2020 sipas komunave.....	15
Prodhimtaria vjetore sipas komunave për periudhën e Planit të Biznesit.....	Error! Bookmark not defined.
1.2. Metodologjia në përpilimin e Planit të Biznesit 2018-2020	16
1.3. Baza ligjore me ndikim të drejtpërdrejtë në ndërmarrje	17
2. DEKLARATAT E KRU “PRISHTINA” SH.A.....	19
2.1. Deklarata e Misionit	19
2.2. Deklarata e Vizionit.....	19
2.3. Deklarata e rrezikut (riskut).....	19
2.4. Tarifa e shërbimit.....	20
2.4.1. Tarifa fikse & volumetrike për shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit	21
(ARRU / UTSH – 551 DT , datë 29.12.2014)	21
2.4.2. Tarifa për administrim dhe shpenzimet e kyçjes në rrjetin e shërbimeve të ujit dhe kanalizimit.....	22
2.4.3. Tarifa për shërbimet tjera	23
3. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË KRU “PRISHTINA” SH.A. PËR PERIUDHËN 2018 – 2020.....	24
3.1. Reduktimi i ujit pa të ardhura	24
3.1.1. Matja e sasisë së ujit të nxjerrë	25
3.1.2. Leximi i matësve – eliminimi i faturimit paushall (aforfe)	25
3.1.3. Konsumi i autorizuar pa ujëmatës dhe i pa-faturuar	26
3.1.4. Analizimi i të dhënave-nxjerrja e përfundimeve.....	26
3.2. Reduktimi i humbjeve komerciale të ujit.....	26

3.2.1.	Humbja e ujit nga hidrantët	26
3.2.2.	Humbja përmes “by pass-e” (anashkalimi i matësit)	27
3.2.3.	Standardizimi i matësve	27
3.2.4.	Eliminimi i gabimeve softuerike	28
3.3.	Rritja e shkallës së arkëtimit në sektorin e amvisërisë	28
3.3.1.	Eliminimi i faturimit paushall (aforfe)	29
3.3.2.	Verifikimi i saktësisë së leximit të matësve	30
3.4.	Rritja- zgjerimi i zonës së shërbimit- furnizimit me ujë të pijes (mbulimi i tërësishëm i zonës)	30
3.5.	Instalimi i matësve inteligjent (smart)	31
3.6.	Integrimi i rrjetit shpërndarës të ujit	32
3.6.1.	Integrimi me rrjetin shpërndarës të Obliqit	32
4.	GJENDJA AKTUALE NË KRU “PRISHTINA” SH.A.	33
4.1.	Gjendja e përgjithshme në KRU "Prishtina" sh.a.	33
4.1.1.	Performanca e përgjithshme e Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit “Prishtina” sh.a. gjatë vitit 2017 ...	34
4.1.2.	Performancat financiare gjatë vitit 2017	34
4.1.3.	Performancat operative në vitin 2017	36
4.1.4.	Performancat operative dhe financiare në vitin 2017	37
4.1.5.	Performanca administrative në vitin 2017	38
5.	STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE PLANIFIKIMI I PERSONELIT	40
5.1.1.	Struktura organizative	40
5.1.2.	Struktura menaxhuese	40
5.1.3.	Skema organizative-organogrami	41
5.2.	Planifikimi i personelit	43
5.2.1.	Numri total i stafit administrativ dhe operativ	43
5.2.2.	Struktura kualifikuese dhe gjinore	43
5.2.3.	Struktura nacionale	44
5.2.4.	Struktura moshës së personelit	44
5.2.5.	Numri i personelit në raport me numrin e konsumatorëve	45
6.	BUXHETI I KRU “PRISHTINA” SH.A.	47
6.1.	Buxheti vjetor për vitin 2018 dhe parashikimet për peiudhën 2019 - 2020	47
6.2.	Buxheti mujor për vitin 2018	48
6.3.	Buxheti- arkëtimet, shpenzimet, investimet kapitale dhe mbetja neto	51
6.4.	Faturimet dhe arkëtimet e shërbimeve bazë	52
6.5.	Struktura e faturimit sipas kategorive për vitin 2018	54
6.6.	Struktura e arkëtimeve sipas kategorive për vitin 2018	55

6.7.	Shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes	56
6.7.1.	Shpenzimet mujore të operimit dhe të mirëmbajtjes për vitin 2018	56
6.7.2.	Shpenzimet vjetore të operimit dhe të mirëmbajtjes për.....	59
	periudhën 2011-2020	59
6.8.	Investimet kapitale në KRU “Prishtina” sh.a.	61
6.9.	Lista e investimeve kapitale 2018-2020	62
6.10.	Treguesit teknik dhe financiar të performancës 2011 - 2020	68
6.11.	Pasqyra e të hyrave tjera operative vjetore 2018-2020	69
7.	TË TJERA.....	70
7.1.	Rregullimi i bazës së të dhënave	70
7.2.	Vërejtjet-paralajmërimi i shkyçjeve	70
7.3.	Ekzekutimi i shkyçjeve nga shërbimi	71
7.4.	Kontratat e shërbimit me konsumatorët	71
7.5.	Riprogramimi i borxheve të akumuluar	72
7.6.	Hulumtimi i opinionit – Niveli i përmbushjes së kënaqësisë së konsumatorëve	72
7.7.	Rritja e kualitetit të shërbimeve administrative	72
7.8.	Hulumtimi i mundësive për pagesën (rimbursimin) e faturave për rastet sociale	73
7.9.	Analiza e shpenzimeve të mundshme të humbura në procedurë gjyqësore	74
7.10.	Fushata e senzibilizimit	74
	Valuta	76
	,000 €	76
7.11.1.	Plani i amortizimit të kamatave dhe principalit, Faza II	76
	Valuta	77
	000 €	77
7.11.2.	Plani i amortizimit të kamatave dhe principalit, Faza III	77
8.	SHTESAT	78
8.1.	Pasqyra e të ardhurave (varianta akruale)	79
8.2.	Performanca financiare	80
8.3.	Performanca operative	80
8.4.	Lista e projekteve të investimeve kapitale, arsyeshmëria e projekteve	81

HYRJE

Prishtina-Kryeqyteti i Republikës së Kosovës -selia qendrore e KRU “Prishtina” sh.a.-

Prishtina është kryeqyteti i Republikës së Kosovës. Prishtina shtrihet buzë rrafshnaltës së pëlleshme rrëzë maleve të argjendta, ashtu sikurse dikur Ulpiana, ka pozitë të përshtatshme gjeografike, ngase gjendet në kryqëzimin e rrugëve parësore kontinentale. Pozita e këtillë gjeostrategjike ka bërë që historia e Prishtinës të përcillet nga shumë ngjarje të rëndësishme historike.

Qyteti ka dy lumenj tanimë të shterrur (të mbuluar me kanale të betonit). Rrethohet nga një kurorë bregore që përbëhet nga Veterniku dhe Matiqani në anën jugore, pyjet e blerta të Gërmisë në lindje dhe Dragodani (Arbëria) në perëndim.

Prishtina ka lartësinë mesatare mbidetare prej 585 deri në 600 metra. Dominohet nga një klimë e zbutur kontinentale. Të shumtën e kohës mbizotërojnë (klime) ditë të nxehta dhe netë të freskëta malore.

Prishtina e sotme, në bazë të të dhënave relevante antike ishte njëra nga tri qytetet e rëndësishme të Dardanisë (ashtu siç quhej atëbotë Kosova e sotme); Justiniana Prima, Justiniana Secunda (Ulpiana) dhe Justinopolis.

Prishtina u themelua nga Perandorët romakë me prejardhje ilire të lindur në Dardani-Justiniani (527-565).

Prandaj edhe emërtimi i saj evoluon gjatë shekujve të më pastajmë- Justiniana, Istriana, Istrina, Pri+Istrina për të marrë përfundimisht trajtën e sotme Prishtina.

Në mesjetë në Prishtinë ekzistonte “rafinatio argenti”, përpunimi vëllimor dhe cilësor i argjendit në afërsi të minierave të Novo Bërdës (Artanës) dhe Trepçës.

Në shekullin XVII qyteti përjeton hovin e një zhvillimi ekonomik më të shpejtuar. Konsiderohej si një vendbanim me më shumë se 3.000 banorë.

Prishtina, tanimë shpërfaqet si një qytet i bukur dhe bashkëkohor, gërshtetuar me gjurmë e tipare karakteristike të kulturave të lashta ilire, romake, bizantine e osmane.

1. PROFILI I KRU “PRISHTINA” SH.A.

1.1. Përshkrimi i ndërmarrjes

1.1.1. Historiku i ndërmarrjes

Profili i Ujësjiellësit, është ngushtë e lidhur me historikun e Prishtinës— kryeqytetit të Kosovës si dhe vendbanimeve që gravitojnë afër kryeqendrës. Pas luftës së Kosovës (1998-1999) kompania i është nënshtruar procesit të konsolidimit përkatësisht regionalizimit. Tash zona e shërbimit është e shtrirë në gjithë territorin e Kosovës Qendrore.

Furnizimi me ujë i Prishtinës, daton që nga kohët e hershme nga burimet natyrale të Gjermisë kurse më vonë nga pusët në Kolevicë. Prishtina në vitin 1961 kishte përafërsisht 38.593 banorë. Në këtë vit fillon shfrytëzimi i liqenit akumulues të Badovcit për furnizimin e qytetit të Prishtinës dhe rrethinës me ujë të pijes.

Në fund të viteve '70 të shekullit të kaluar, paralelisht me rritjen e zhvillimeve urbanistike në qytetin e Prishtinës dhe rrethinës fillon edhe rritja e kërkesave për ujë të pijes dhe largimin e ujërave të ndotura. Shtohen sasi të ujit të pijes duke shfrytëzuar akumulimin e liqenit të Batllavës, burimet nëntokësore në Fushë Kosovë dhe Obiliq. Përveç shtimit të sasisë së ujit në këtë periudhë janë bërë edhe investimet kualitative në rrjetin shpërndarës të ujit të pijes dhe ujërave të zeza.

Në vitin 2007 ndërmarrja, shëndrrohet në shoqëri aksionare me emërtimin: **Kompania Ujësjiellësi Rajonal “Prishtina”-shoqëria aksionare** që përfshin ofrimin e shërbimeve në komunat; **Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq, Shtime, Lipjan, Podujevë , Gllogoc dhe Graçanicë.** **KRU “Prishtina”** është ndërmarrja më e madhe e furnizimit me ujë të pijes në Republikën e Kosovës.

1.1.2. Lokacionet e KRU "Prishtina" sh.a.

Më 12.10.2016 ndërmarrja është emërtuar me emrin; **Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Prishtina" sh.a.**

KRU 'Prishtina' sh.a. është entitet unik, i rexhistruar në Ministrinë e Tregëtisë dhe Industrisë në numrin **70423736**. Selia qendrore e ndërmarrjes ndodhet në Prishtinë (kodi 10000), në rrugën "Haxhi Shala" numër 4, telefoni +381 38 603211, fax +381 38 603347, mobil; +37744520270 dhe +37745705112, postë elektronike info@kru-prishtina.com, ueb faqe: www.kru-prishtina.com.

Në selinë qendrore të kompanisë kryhen të gjitha veprimet e administrimit financiar, logjistik, administrativ dhe të përfaqësimit me palët e treta,

Njësitë operative të ujësjellësit të organizuara nëpër komunat e zonës së shërbimit ndodhen në adresat:

1. NJOU në Fushë Kosovë, nuk ka në pronësi objekt në të cilën zhvillon aktivitetet e operimit. Në kuadër të njësisë kryhen vetëm disa veprime të thjeshta operative dhe financiare (që lidhen me lexim të ujematësve, faturim, arkëtim dhe evidentim të kërkesave-ankesave nga ana e konsumatorëve). Të gjitha punët dhe veprimet tjera janë të deleguara te personeli i paracaktuar në zyret (selinë) qendrore në Prishtinë.

Aktualisht objekti në rrugën , "7 Shtatori ", p.n. është i marrur me qera për një periudhë të caktuar kohore.

Komunikimi me NJOU në Fushë Kosovë bëhet përmes telefonit mobil; +37745705113

2. NJOU në Obiliq një numër të kufizuar të aktiviteteve ditore operative dhe financiare i zhvillon në objektin administrativ në rrugën "Hasan Prishtina ", pa numër. Të gjitha veprimet tjera i delegon te personeli i caktuar në selinë qendrore në Prishtinë.

Komunikimi zyrtar me NJOU në Obiliq bëhet në telefoninë fikse +381 38 560 013 dhe telefonin mobil; +37745705114

3. NJOU në Graçanicë, nuk ka në pronësi objekt në të cilën zhvillon aktivitetet e operimit. Në kuadër të njësisë kryhen vetëm disa veprime të thjeshta operative dhe financiare (që lidhen me lexim të ujematësve, faturim, arkëtim dhe evidentim të kërkesave-ankesave nga ana e

konsumatorëve). Të gjitha punët dhe veprimet tjera janë të deleguara te personeli i paracaktuar në zyret (selinë) qendrore në Prishtinë.

Aktualisht objekti në rrugën, "Car Lazar ", pa numër është i marrur me qera për një periudhë të caktuar kohore.

Komunikimi zyrtar bëhet përmes telefonit mobil; +37745705115.

4. NJOU në Shtime, një numër të kufizuar të veprimeve operative dhe financiare i kryen në objektin administrative dhe bazën teknike që ndodhet në rrugën, "Isa Boletini" , nr 5 në Shtime. Të gjitha punët dhe veprimet tjera janë të deleguara te personeli i paracaktuar në zyret (selinë) qendrore në Prishtinë.

Komunikimi zyrtar bëhet përmes telefonit mobil numër; +3774570516

5. NJOU në Lipjan, një numër të kufizuar të veprimeve operative dhe financiare i kryen në objektin administrativ dhe bazën teknike që ndodhet në rrugën, "12 Qershori", në Lipjan. Të gjitha punët dhe veprimet tjera janë të deleguara te personeli i paracaktuar në zyret (selinë) qendrore në Prishtinë.

Komunikimi zyrtar bëhet përmes telefonisë fikse numër + 381 38 582829 dhe telefonisë mobile numër +3774570517

6. NJOU në Podujevë, një numër të kufizuar të veprimeve operative dhe financiare i kryen në objektin administrativ dhe bazën teknike që ndodhet në rrugën e "Brigadave ", pa numër. Të gjitha punët dhe veprimet tjera janë të deleguara te personeli i paracaktuar në zyret (selinë) qendrore në Prishtinë.

Komunikimi zyrtar bëhet përmes telefonisë fikse numër +381 38 570507 dhe telefonisë mobile +37745705118.

7. NJOU në Drenas, nuk ka në pronësi objekt në të cilën zhvillon aktivitetet e operimit. Në kuadër të njësisë kryhen vetëm disa veprime të thjeshta operative dhe financiare (që lidhen me lexim të ujëmatësve, faturim, arkëtim dhe evidentim të kërkesave-ankesave nga ana e konsumatorëve). Të gjitha punët dhe veprimet tjera janë të deleguara te personeli i paracaktuar në zyret (selinë) qendrore në Prishtinë.

Aktualisht objekti në rrugën, “Feronikel” shfrytëzohet bashkërisht me Ndërmarrjen Publike “Pastrimi”. Për shfrytëzimin e këtyre hapësirave administrative dhe bazës teknike nuk paguhet asnjë lloj qeraje.

Komunikimi zyrtar bëhet përmes telefonisë fikse numër +381 38 384708 dhe telefoni mobile numër +37745705118

1.1.3. Profili i konsumatorëve të KRU “Prishtina” sh.a.

Urdhëresa tarifore në zbatim për periudhën 2018-2020 specifikon vetëm dy kategori të konsumatorëve; shtëpiak (amvisëri) dhe jo shtëpiak (institucione, biznese, industri etj). KRU “Prishtina” sh.a. për nevoja të një planifikimi dhe monitorimi më të mirë, ka ndarë më tutje në katër kategori të konsumatorëve.

1. Amvisëria
2. Bizneset e vogla
3. Bizneset e mëdha
4. Institucionet vendore dhe ndërkombëtare

Profili i konsumatorëve të KRU “Prishtina” sh.a., është shumë heterogjen. Madje madje edhe brenda kategorisë së njëjtë të ndarjeve apo edhe nëndarjeve vërehet heterogjeniteti i tyre.

Në përfundim të muajit gusht 2017 numri i konsumatorëve aktiv që marrin shërbime është 126.300 konsumatorë. Kategorizimi dhe struktura në përqindje e konsumatorëve të KRU “Prishtina” sh.a. është si në tabelën në vazhdim.

Elementet	€	Prishtina	Fushë Kosova	Obiliqi	Graçanica	Shtime	Lipjani	Podujeva	Drenasi	Total
Nr. Konsum. në amvisëri	#	71,164	14,758	5,900	2,959	2,888	8,194	7,172	4,089	117,124
Nr. Konsum. në bizneset e vogla	#	9,115	954	315	498	279	605	1,013	622	13,401
Nr. Konsum. në bizneset e mëdha	#	1,089	54	32	134	16	131	36	19	1,512
Nr. Konsumuar në institucione arsimore dhe shëndetësore	#	473	36	37	40	50	59	46	27	767
Numri total i konsumatorëve	#	81,841	15,802	6,283	3,632	3,233	8,990	8,267	4,757	132,803
Pjesmarrja e numrit të konsumatorëve sipas kategorive në totalin e numrit të konsumatorëve										
Nr. Konsum. në amvisëri	€	60.76%	12.60%	5.04%	2.53%	2.47%	7.00%	6.12%	3.49%	100.00%
Nr. Konsum. në bizneset e vogla	€	68.02%	7.12%	2.35%	3.72%	2.08%	4.51%	7.56%	4.64%	100.00%
Nr. Konsum. në bizneset e mëdha	€	72.03%	3.57%	2.12%	8.88%	1.06%	8.69%	2.39%	1.26%	100.00%
Nr. Konsumuar në institucione arsimore dhe shëndetësore	€	61.64%	4.69%	4.82%	5.18%	6.50%	7.69%	5.96%	3.52%	100.00%
Numri total i konsumatorëve	€	61.63%	11.90%	4.73%	2.73%	2.43%	6.77%	6.22%	3.58%	100.00%
Pjesmarrja e numrit të konsumatorëve sipas kategorive në totalin e numrit të konsumatorëve										
Nr. Konsum. në amvisëri	%	86.95%	93.39%	93.89%	81.49%	89.34%	91.15%	86.75%	85.96%	86.75%
Nr. Konsum. në bizneset e vogla	%	11.14%	6.04%	5.01%	13.72%	8.63%	6.73%	12.26%	13.08%	12.26%
Nr. Konsum. në bizneset e mëdha	%	1.33%	0.34%	0.51%	3.70%	0.49%	1.46%	0.44%	0.40%	0.44%
Nr. Konsumuar në institucione arsimore dhe shëndetësore	%	0.58%	0.23%	0.59%	1.09%	1.54%	0.66%	0.55%	0.57%	0.55%
Numri total i konsumatorëve	%	100.00%	100.00%	100.00%	100.00%	100.00%	100.00%	100.00%	100.00%	100.00%

1.1.4. Zona e Shërbimit


Zona në të cilën KRU “Prishtina” sh.a. kryen shërbime të ujit të pijes dhe largimit të ujërave të zeza shtrihet në 8 komuna të Kosovës Qendrore, dhe në një komunë tjetër (Vushtrria) që kryen shërbime vetëm në pak fshatra në kufi me Obiliqin.

Komunat që marrin shërbime janë:

- Prishtinë
- Fushë Kosovë

- Obiliq
- Graçanicë
- Shtime
- Lipjan
- Podujevë dhe
- Drenas

Zona e mbulimit të përafërt me shërbime të ujit dhe kanalizimit e inkorporuar në hartën e Republikës së Kosovës është paraqitur në grafikun e mëposhtëm. Kjo zonë është kufizuar me ngjyrën e kuqe dhe përmban në vete 8 komunat të përqendruara në Kosovën Qendrore:



1.1.5. Burimet e ujit të KRU “PRISHTINA” sh.a.

KRU “PRISHTINA” sh.a. ka një sistem shumë kompleks të prodhimit dhe përpunimit të ujit. Aktualisht uji i papërpunuar merret nga Liqenet akumuluese, kanalet e ujitjes, burimet nëntokësore-puset etj. Sasia e e përgjithshme e ujit të përpunuar e vënë në dispozicion të konsumatorëve brenda sistemit të KRU "Prishtina" sh.a. pompohet minimalisht një herë dhe maksimalisht 4 herë. Prandaj kostoja e prodhimit dhe shpërndarjes është e lartë (konsumi i madh i energjisë elektrike, kimikateve dhe amortizimi i pompave-elektromotorëve).

Në këtë paragraf po tregojmë vetëm burimet nga të cilat bëhet nxjerrja dhe trajtimi fillestar i ujit të pijes.

1.1.5.1. Fabrika për përpunimin e ujit në Shajkovc

Fabrika e përpunimit të ujit në Shajkovc, ujin e papërpunuar e merr në liqenin artificial akumulues në Batllavë. Sipërfaqja e akumulimit në kuotën maksimale ka madhësinë prej 2,69 km². Sasia bruto e ujit të akumuluar në kuotën maksimale është 45.500.000 m³.

1.1.5.2. Fabrika për përpunimin e ujit në Badovc

Fabrika e përpunimit të ujit në Badovc, ujin e papërpunuar e merr në liqenin artificial akumulues me të njëjtin emër. Sipërfaqja e akumulimit në kuotën maksimale ka madhësinë prej 1,16 km². Sasia bruto e ujit të akumuluar në kuotën maksimale është 38.400.000 m³.

1.1.5.3. Fabrika për përpunimin e ujit në Shkabaj

Fabrika e përpunimit të ujit në Shkabaj, është vënë në punë provuese me 17.03.2017 si rezultat i investimeve vetanake dhe donacioneve nga Komuna e Prishtinës, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Komisioni Evropian.

Kapaciteti i instaluar i përpunimit të ujit është 700 l/s. Deri në periudhën, në të cilën ka filluar përgatitja e këtij Plani të Biznesit, Fabrika ka punuar me kapacitet përafërsisht të përgjysmuar.

Testimi i stabilimenteve për përpunim të sasisë së instaluar të ujit është bërë dhe është treguar i sukseshëm.

Uji i pa përpunuar për këtë fabrikë merret në liqenin artificial akumulues në Gazivodë (Ujman). Sasia bruto e ujit të akumuluar në këtë liqe atëherë kur niveli i ujit arrin në kuotën maksimale është 350.000.000 m³.

1.1.5.4. Stacioni për përpunimin e ujit në Drenas

Stacioni për përpunim të ujit në Bivolak ka kapacitet prej 60 l/s. Ujin fillestar e merr nga kanali i hapur për ujitje në Bivolak përkatësisht nga liqeni artificial akumulues në Gazivodë. Sasia bruto e ujit të akumuluar në kuotën maksimale është 350.000.000 m³.

1.1.5.5. Stacionet për pompimin dhe përpunimin e ujit

Në KRU “Prishtina” sh.a. ekzistojnë edhe këto stacione të përpunimit dhe pompimit të ujit të pijes:

- Stacioni i pompimit Kroni, kapaciteti 50 l/s.
- Stacioni i pompimit Kastrioti, kapaciteti 20 l/s.
- Stacioni i pompimit Shtime, kapaciteti 30 l/s.
- Stacioni i pompimit Lipjani, kapaciteti 50 l/s.
- Stacioni i pompimit Podujeva, kapaciteti 18 l/s.
- Stacioni i pompimit Vragoli, kapaciteti 20 l/s.

1.1.5.6. Rrjeti shpërndarës i ujit të pijes

Infrastruktura e furnizimit me ujë të pijes është komplekse dhe shumë e ndërthurur. Në shumicën e rasteve bashkë me rrjetin e ujit shkon paralelisht edhe rrjeti i ujërave të zeza, duke respektuar standardet minimale që përcaktohen me rregullativën e furnizimit me ujë të pijes.

Rrjetin e shpërndarjes së ujit të pijshëm e kompletojnë:

Rrjeti primar i shpërndarjes së ujit në gjatësi prej 1200 km

Rrjeti sekondar i shpërndarjes në gjatësi prej 700 km

Depozitë (rezervuare) me vëllim $V = 70.000 \text{ m}^3$,


Rrjeti primar për bartjen e ujërave të zeza në gjatësi prej 3 km,

FENNA

1.1.5.7. Prodhimtaria mujore në m3 për vitin 2018-2020 sipas komunave

Prodhimtaria vjetore sipas komunave për periudhën e Planit të Biznesit

Emërtimi	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	2018	2019	2020
Albaniku	1,740,926	1,516,290	1,684,767	1,628,608	1,684,767	1,684,767	1,853,244	1,909,403	1,740,926	1,684,767	1,628,608	1,740,926	20,498,000	20,498,100	20,498,150
Badovci	857,044	746,458	829,397	801,751	829,397	829,397	912,337	939,984	857,044	829,397	801,751	857,044	10,091,000	10,091,100	10,091,150
Shkabaj	1,339,200	1,166,400	1,296,000	1,252,800	1,296,000	1,296,000	1,425,600	1,468,800	1,339,200	1,296,000	1,252,800	1,339,200	15,768,000	15,768,100	15,768,150
Kroni & Vragolia	214,197	186,559	207,288	200,378	207,288	207,288	228,016	234,926	214,197	207,288	200,378	214,197	2,522,000	2,522,100	2,522,150
Shtime	66,926	58,290	64,767	62,608	64,767	64,767	71,244	73,403	66,926	64,767	62,608	66,926	788,000	788,100	788,150
Kastrioti	58,858	51,263	56,959	55,060	56,959	56,959	62,655	64,553	58,858	56,959	55,060	58,858	693,000	693,100	693,150
Lipjani	160,690	139,956	155,507	150,323	155,507	155,507	171,058	176,241	160,690	155,507	150,323	160,690	1,892,000	1,892,100	1,892,150
Podujeva	26,329	22,932	25,479	24,630	25,479	25,479	28,027	28,877	26,329	25,479	24,630	26,329	310,000	310,100	310,150
Drenasi	107,099	93,279	103,644	100,189	103,644	103,644	114,008	117,463	107,099	103,644	100,189	107,099	1,261,000	1,261,100	1,261,150
TOTALI	4,571,268	3,981,427	4,423,808	4,276,348	4,423,808	4,423,808	4,866,189	5,013,649	4,571,268	4,423,808	4,276,348	4,571,268	53,823,000	53,823,900	53,824,350



1.2. Metodologjia në përpilimin e Planit të Biznesit 2018-2020

Plani i biznesit 2018-2020, këtë vit përputhet edhe me periudhën kohore të vlefshmërisë së Tarifës së shërbimit. Deri në kohën e përgatitjes së Planit të Biznesit ARRU nuk ka trajtuar Aplikacionin Tarifor dhe të gjitha përllogaritjet dhe analizat janë bërë në bazë të Urdhëresës Tarifore për Shërbim të periudhës 2015-2017. Ndryshimi eventual i tarifës, për të cilën gjë është bërë edhe Aplikacioni do të nënkuptojë edhe procesin e rishikimit të Planit të Biznesit sepse implikimet janë edhe të natyrës financiare.

Plani i Biznesit gjithashtu është dokument, që veç tjerave përgaditet edhe si detyrim që del nga neni 30 i Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike nr. 03/L-087 lidhur me nenin 17 dhe 18 të Ligjit nr, 04/L-111 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike.

Me këtë Plan, janë përcakuar orientimet dhe objektivat zhvillimore të Kompanisë duke marrë për bazë rezultatet e pritshme. Janë marrë në konsideratë edhe rezultatet (historike) e arritura përgjatë viteve të kaluara.

Plani i Biznesit është përgatitur duke pasur parasysh gjendjen ekzistuese të Kompanisë, trendet e zhvillimit të sektorit të ujit në Kosovë dhe region me qëllim që të adoptohen praktikat më të mira për një zhvillim të qëndrueshëm finciar dhe tekniko-teknologjik të Kompanisë. Gjithashtu në të gjitha fazat e hartimit, zhvillimit dhe implementimit të të gjitha dokumenteve strategjike është marrë në konsideratë edhe ambienti ekonomik dhe socio-kulturor në Republikën e Kosovës.

Parametrat finciar dhe operativ janë dizajnuar, ridizajnuar dhe analizuar duke përdorë metodat krahasuese dhe empirike në mënyrë që të jenë të arritshme (duke lënë mundësinë e tejkalimit të të njëjtave) dhe sa më afër me realitetin.

Plani i Biznesit, merr parasysh strategjinë zhvillimore të Institucioneve të Republikës së Kosovës për sektorin e ujit si në nivel qeveritar edhe në nivel komunal, njëkohësisht edhe Direktivat Evropiane për ujin e pijes dhe ujërat e zeza.

Plani i Biznesit është ndërtuar mbi bazën e dokumentit burimor të Procesit tarifar për periudhën 2018-2020.

Akcionari, menaxhmenti si dhe të gjithë të punësuarit do të jenë të angazhuar maksimalisht që me punën e tyre të realizojnë objektivat që dalin nga ky Plan, në mënyrë që Kompania të arrijë të përmbushë vizionin dhe misionin.

1.3. Baza ligjore me ndikim të drejtpërdrejtë në ndërmarrje

KRU “Prishtina” është e organizuar në cilësinë e shoqërisë tregtare. Akcionet janë të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Veprimtarinë e vet operative dhe financiare do t’a organizojë dhe përmbushë duke pasur për bazë detyrimet në zbatimin e akteve dhe dispozitave ligjore të miratuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës:

- Ligji mbi Ndërmarrjet Publike (Nr. 03/L-087)
- Ligji nr, 04/L-111 për Plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike.
- Ligji mbi Ofruesit e Shërbimeve të Ujit dhe Mbeturinave (Nr. 03/-L-086)
- Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike(2008/03 L048)
- Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi (2012/04-L-116)
- Ligji mbi Shoqëritë Tregtare 02/L-123

- Ligji nr.04/L 006 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shoqëritë Tregëtare
- Ligji mbi Ujërat (04/L-147)
- Ligji i Punës (2010/03-L-212)
- Ligji mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale (2010/03-L-172)
- Ligji mbi Festat Zyrtare (03/L-064)
- Ligji i Punës (03/L-212) etj

FENNA

2. DEKLARATAT E KRU “PRISHTINA” SH.A.

2.1.Deklarata e Misionit

Prodhimi, përpunimi dhe furnizimi i qëndrueshëm me ujë cilësor të pijshëm të qytetarëve të Prishtinës, Fushë Kosovës, Obiliqit , Graçanicës, Shtimes, Lipjanit, Podujevës dhe Drenasit si dhe trajtimi i ujërave të zeza në përputhshmëri me standardet dhe kërkesat statusore dhe legislative të ndërmarrjes dhe aksionarit.

2.2.Deklarata e Vizionit

Ndërmarrje për prodhimin, përpunimin dhe furnizimin e ujit të pijshëm dhe trajtimit të ujërave të zeza për konsumatorët e saj në përputhshmëri me standardet e ndërmarrjeve të ngjashme në regjion dhe Evropë.

2.3.Deklarata e rrezikut (riskut)

Përgatitja e Planit të Biznesit nisët mbi bazën e parimit të vazhdimësisë në një periudhë shumë të gjatë kohore (uji është elementi kryesor i jetës së konsumatorëve prandaj vazhdimësia është e padiskutueshme). Rreziqet e mundshme në aspektin e parashikimit për periudhën të cilën e përfshinë Plani i biznesit dhe pamundësia e përmbushjes së “misionit”, “vizionit” dhe objektivave të parapërcaktuara mund të përmbliidhen si:

Mungesa eventuale e rezervave të ujit (mungesë e reshjeve atmosferike), koha kur po përgatitet ky Plan gjendja e rezervave të ujit në Liqenin e Batllavës dhe në Liqenin e Badovcit nuk është shumë e favorshme),

Ngritja e kostos së jetesës (rritja e tarifës së energjisë elektrike, karburanteve, pjesëve të ndërrimit etj),

Mos ngritja e tarifës së shërbimit përkundrejt rritjes së standardeve dhe trendeve zhvillimore, përfshirë rritjen e sasisë së ujit të prodhuar pas funksionalizimi të fabrikës në Shkabaj

Mos qëndrueshmëria financiare e ndërmarrjes,

Kontaminimet eventuale te burimeve të furnizimit me ujë të pijshëm,

Rritja e shkallës së humbjeve të ujit si rezultat i rritjes së sasisë së ujit nga fabrika e re në Shkabaj përreth 10 milion m³ ujë më shumë,
Mos arkëtimi i borxheve të këqija,
Lëvizjet sociale,
Krizat politike ,
Amortizimi i rrjetit, armaturave dhe fittingjeve si rezultat i vjetërsisë,
Forcat tjera madhore (tërmeti, vërshimet, zjarret, ndryshimet klimatike etj).

2.4.Tarifa e shërbimit

Kompania Rajonale Ujësjellësi “Prishtina” sh.a. zbaton tarifën që vendosë Autoriteti Rregullativ i Ujërave e që është kompetent në bazë të Ligjit mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit Kanalizimit dhe të Mbeturinave (Ligji Nr. 03/L-086).

Në bazë të tarifës aktuale (duke marrë në konsideratë edhe shkallën e arkëtimit dhe nivelin e humbjeve teknike dhe komerciale) mund të bëhet në tërësi vetëm mbulimi i kostove operative por jo edhe kostove të mirëmbajtjes dhe investimeve kapitale. Kjo nënkupton se tarifat ekzistuese nuk garantojnë investime më të mëdha drejt përmirësimit të bazës materiale dhe për shërbime më të mira për konsumatorët pa implikimin e ndihmave nga fondet tjera përfshirë donacionet, kreditë komerciale, grantet dhe subvencionet qeveritare.

Zbatimi i tarifës së miratuar në ciklin tarifar 2018-2020 duke mos e apstrahuar as korrigjimin e tarifës (rritjes) gjatë kësaj periudhe kohore për shkak të:

Kthimin e kryegjësë dhe kamatave për kredinë e Fazës II dhe III të investimeve.

Kërkesa për të financuar planin e investimeve kapitale,

Rritjes së tarifës së energjisë elektrike ,

Blerjen e ujit të papërpunuar për Fabrikën për Trajtimin e Ujit të Pijes në Shkabaj (500 l/sec)

Rritja e numrit të personelit të nevojshëm për Fabrikën për Trajtimin e Ujit të Pijes në Shkabaj.

Rritjen e vazhdueshme të numrit të konsumatorëve në zonën e shërbimit, kryesisht në qytetet e veçanërisht; Prishtinë dhe Fushë Kosovë.

Zgjerimi i zonës së shërbimit edhe me fshatra e lokalitete që më parë nuk kanë pasur shërbime të ujit, e veçanërisht të kanalizimit.

Rritja e nivelit të amortizimit;

Rritjen e çmimit të karburanteve,

Rritja e vlerës së shërbimeve nga palët e treta.

Prandaj zbatimi i tarifës do të ndikojë pozitivisht dhe do të mobilizojë menaxhmentin dhe personelin tjetër në KRU “Prishtina” sh.a. në përmbushjen me sukses të misionit të përcaktuar.

Korrigjimi-rritja e tarifës konsiderojmë se do të ketë efektin domino edhe te konsumatorët në : stimulimin e kursimit të ujit,

shërbime më të mira ndaj konsumatorëve

Autoriteti Rregullativ për Ujë, me procesin e fundit tarifar ka përcaktuar rritje të vazhdueshme të tarifës ekuivalent me rritjen e kostos së jetesës, përkatësisht nivelin mesatar vjetor të inflacionit.

2.4.1.Tarifa fikse & volumetrike për shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit (ARRÜ / UTSH – 551 DT , datë 29.12.2014)

Kategoria e konsumatorëve	Tarifa fikse Euro/muaj	Tarifa volumetrike për shërbime të ujësjellësit Euro/m3	Tarifa volumetrike për shërbime të kanalizimit Euro/m3
3.1. Tarifat pa inflacion të përcaktuara për vitin 2016 (vlefshmëria 01.01.2017 - 31.12.2017)			
Shtëpiak	1,00	0,3874	0,0461
Institucional dhe Industrial/Komercial	3,00	0,8400	0,1013
3.2. Tarifat e aplikueshme për vitin 2017 mbi bazën e indeksit të çmimeve të konsumit të publikuara nga ASK për periudhën 12/2015 deri 11/2016 (vlefshmëria 01.01.2017 - 31.12.2017)			
Shtëpiak	1,00	0,39	0,05
Institucional dhe Industrial/Komercial	3,00	0,88	0,11

2.4.2. Tarifa për administrim dhe shpenzimet e kyçjes në rrjetin e shërbimeve të ujit dhe kanalizimit

2.1. Tarifa Administrative për Kyçje në Shërbime	Diametri i gypit të kyçjes / ujëmatësi	Shuma Euro
Për të gjithë kategoritë e konsumatorëve (*) –Tarifa për administrim është e pakthyeshme dhe nënkuptojmë të drejtën e konsumatorit për tu kyç në rrjetin e shërbimeve të ujit dhe mbajtjen e tij në regjistrin e konsumatorëve aktiv për çështje të ndryshme administrative.	(13 – 25) mm	5,00
	32 mm	5,00
	40 mm	5,00
	50 mm	5,00
	65 mm	5,00
	80 mm	5,00
	100 mm	5,00
	150 mm	5,00
2.2. Shpenzimet e kyçjes në Shërbime të Ujësjiellësit*	Diametri i gypit të kyçjes/ujëmatësit	Shuma Euro
Për të gjitha kategoritë e konsumatorëve (*) - Shpenzimet e kyçjes në Shërbime përfshijnë shpenzim të punës dhe materialit në vijim: qafore, pajisjet për kyçje, gypat e kyçjes në gjatësi deri 15 metra, ujëmatësi dhe dy valvula. Punët tokësore dhe ato të betonit nuk janë të përfshira.	(13 – 20) mm	120,00
	(25 – 32) mm	160,00
	(40 – 50) mm	220,00
	> 50mm	Do të llogaritet në bazë të çmimeve për material dhe punën.
2.3. Shpenzimet e Kyçjes në Shërbimet e Kanalizimit *	Diametri i gypit të kyçjes/ujëmatësit	Shuma Euro
Për të gjitha kategoritë e konsumatorëve *Shpenzimet e Kyçjes në Shërbime përfshijnë shpenzimin e punës dhe të materialit në vijim: elementet fazonike për kyçje dhe gypit në gjatësi deri 15 metra.	DN 110 mm	100,00
	DN 160 mm	120,00
	DN 200 mm	160,00
	> 200 mm	Do të llogaritet në bazë të çmimeve për material dhe punën.

2.4.3. Tarifa për shërbimet tjera

Lloji i shërbimit	Shuma Euro
3.1. Dërgimi i njoftimit për shkyçje (një herë brenda vitit kalendarik)	3,00
3.2. Shkyçja e shërbimeve të ujësjellësit	20,00
3.3. Rikycja e shërbimeve të ujësjellësit	20,00
3.4. Riparimi i rrjedhjeve në objektin e konsumatorit	Do të llogaritet në bazë të çmimeve për material dhe punën.
3.5. Gjoha për kyçje ilegale	100,00
3.6. Gjoha për moskryerje të riparimit të rrjedhjes në objektin e konsumatorit aplikohet pas vërejtjes së parë	100,00
3.7. Shitja e ujit me cisterna të ujit – transporti deri në 5 km	20,00 € / 5 m3
3.8. Riparimi i ujëmatësit nga çmimi i ujëmatësit kur kompania instalon ujëmatësit e saj	Max. 60 % të çmimit të ujëmatësit
3.9. Kontrollimi i ujëmatësit – verifikimi i saktësisë	15,00

Deri në kohën e përgatitjes së Planit të Biznesit ARRU nuk ka trajtuar Aplikacionin tarifor dhe të gjitha përllogaritjet dhe analizat janë bërë në bazë të Urdhëresës tarifore për shërbim të periudhës 2015-2017. Ndryshimi eventual i tarifës, për të cilën gjë është bërë edhe Aplikacioni do të nënkuptojë edhe procesin e rishikimit të Planit të Biznesit sepse implikimet janë edhe të natyrës financiare.

3. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË KRU “PRISHTINA” SH.A. PËR PERIUdhËN 2018 – 2020

Deklarata e “misionit”, “vizionit” nga njëra anë, si dhe procesi i vazhdimësisë së veprimtarisë së KRU “Prishtina” sh.a. kërkon përkushtim, dije, përkrahje institucionale dhe mjete të lira financiare për investime të reja drejt zhvillimit dhe përparimit tekniko teknologjik në lëminë e përpunimit të ujit për pije dhe mirëmbajtjen e rrjetit të ujërave të zeza.

Konsumatorët në zonën e shërbimit aktualisht kanë një furnizim cilësor dhe sasior me ujë të pijes. Reduktimet e planifikuara kanë filluar të hiqen në tërësi. Konsumatorët, në kuotat e larta, kryesisht ata në qytetin- Prishtinë, problemet e furnizimit me ujë sidomos në sezonin e verës i kanë më të theksuara prandaj mbi bazën e këtij fakti të një përceptimi të gjendjes aktuale dhe dëshirave se si do të jetë në të ardhmen ndërmarrja janë përcaktuar edhe objektivat strategjike.

3.1.Reduktimi i ujit pa të ardhura

Uji i humbur në rrjetin e furnizimit aktualisht paraqet shqetësimin më të madh për të tanishmen dhe ardhmërinë e ndërmarrjes. Humbjet e ujit janë rritur sidomos pas vënjes në funksion të fabrikës në Shkabaj. Ndërmarrja do të shtoj aktivitetet që të vëjë në kontroll dhe të zvogëlojë sasinë e ujit pa të ardhura. Aktivitetet në investime kapitale dhe të mirëmbajtjes të filluara në vitet paraprake 2015, 2016 dhe 2017 pritet që efektet e para do të vërehen në vitin e parë të këtij Plani të Biznesit (2018).

Rritja e sasisë së ujit të përpunuar të futur në rrjetin e shpërndarjes sidomos pas lëshimit në punë të Fabrikës së Përpunimit të Ujit në Shkabaj ka shkaktuar rritje të shkallës së humbjeve

teknike dhe administrative të ujit. Ndërmarrja ka nisur aktivitete shtesë për të stabilizuar këtë tregues shumë të rëndësishëm.

Uji pa të ardhura në fund të vitit 2017 pritet të jetë rreth 58 %. Rritja e shkallës së humbjeve teknike dhe administrative të ujit gjatë vitit 2017 në krahasim me vitin 2016 konsiston në faktin se në sistem është shuar sasia e ujit të përpunuar që natyrisht në muajt e pare nuk ka implikime edhe në tendencën e sasisë së faturuar të ujit për konsumatorët.

3.1.1. Matja e sasisë së ujit të nxjerrë

Aktualisht ndërmarrja bënë matjen e sasisë së përgjithshme të ujit që nxirret nga nëntoka përkatësisht që tërhiqet nga liqenet akumuluese për përpunim të mëtutjeshëm, për detaje referoju në tabelën në faqen 15.

3.1.2. Leximi i matësve – eliminimi i faturimit paushall (aforfe)

Gjendja aktuale në leximin e matësve individual konsiderohet shumë e kënaqshme dhe në total arrin 96,20 % (për vitin 2017) dhe që paraqet shkallën më të lartë të konsumit të matur në Republikën e Kosovës mbase edhe në Rajon dhe më gjërë.

-Në sektorin e amvisërisë sasia e ujit që faturohet me matje arrin shkallën prej 95,40 %. Kjo konsiderohet si një përqindje gati absolute e kënaqshme dhe tendenca për përmirësim është e vështirë.

- Në sektorin e bizneseve të vogla sasia e ujit që faturohet me matje arrin shkallën prej 99,02 %. Kjo konsiderohet si një përqindje gati absolute e kënaqshme dhe tendenca për përmirësim është e vështirë por edhe e panevojshme.

-Në sektorin e bizneseve të mëdha – industria, sasia e ujit që faturohet me matje arrin shkallën prej 100 %. Kjo konsiderohet si një përqindje absolute, tendenca për përmirësim është e panevojshme.

-Në sektorin e institucioneve sasia e ujit që faturohet me matje arrin shkallën prej 100 %. Kjo konsiderohet si një përqindje gati absolute e kënaqshme dhe tendenca për përmirësim është e vështirë.

3.1.3. Konsumi i autorizuar pa ujëmatës dhe i pa-faturuar

Mungesa e sasive të nevojshme të ujit për plotësimin e nevojave bazike të qytetarëve ka bërë që të gjinden mundësi alternative për përmbushjen e nevojave tjera që klasifikohen si në grupin e fontanave publike, larje të rrugëve apo edhe përdorimi i ujit të pijes për ujitjen e hapësirave publike të gjelbëruara. Ndërmarrjet e specializuara kanë hapur puse përkatëse.

Aktualisht vetëm shfrytëzimi i ujit për mirëmbajtjen e rrjetit të ujërave të ndotura nga vetë kompania bëhet duke shfrytëzuar ujin e pijes. Sasia e përdorur për këtë qëllim e krahasuar me sasinë totale të prodhimit është e papërfillshme dhe maksimalisht mund të jetë rreth 15.000 m³ ose përafërsisht 0.03 %. Kjo sasi faturohet në tërësi.

Ndërmarrja ka diskutuar për një plan dinamik, që realisht në disa zona – fshatëra të Lipjanit (projektet me IRD-në), janë vendosur ujëmatës te hidrantët etj.

3.1.4. Analizimi i të dhënave-nxjerrja e përfundimeve

Ndërmarrja në fazat e mëvonshme të ristrukturimit të personelit do të kujdeset që në fillim të procesit do të krijojë njësi të veçantë me personel të kualifikuar që do të bëjë analizimin e të dhënave dhe nxjerrjen e rekomandimeve .

3.2. Reduktimi i humbjeve komerciale të ujit

Ndërmarrja, është duke bërë përpjekje për të bërë ndarjen e ujit pa të ardhura midis humbjeve teknike dhe humbjeve administrative-komerciale.

Punësimi i lexuesve të matësve (inkasantëve), inspektorëve të rrjedhjeve dhe inspektorëve të shkyqjes së shërbimit kanë ndikuar në detektimin e vazhdueshëm të lidhjeve të paligjshme në rrjetin e furnizimit. Në raste të identifikuara aplikohen rregullat e brendshme dhe rregulloret e ARRU-ut.

3.2.1. Humbja e ujit nga hidrantët

Ndërmarrja do të inventarizojë të gjithë hidrantët në zonën e furnizimit. Krijimi i bazës së të dhënave për të ditur funksionalitetin e tyre dhe shfrytëzuesit potencial (zjarrfikësit, policia etj),

që të sigurojë të bëjë mbikëqyrjen profesionale. Të gjejë mundësi teknike që persona të paaautorizuar të mos kenë qasje në ujë.

3.2.2.Humbja përmes “by pass-e” (anashkalimi i matësit)

Ndërmarrja, në kushtet e investimeve të Fazës I-rë dhe Fazës II-të në rrjetën e shpërndarjes në zonën përkatëse të shërbimit (Prishtinë) do të eliminojë anashkalimin e matësve përmes vendosjes së matësve jashtë pronës së konsumatorit (rrugë, trotuare etj) atje ku qasja e klientit për aktivizimin e “by passa-ve” është e kufizuar.

Fokusimi i ndërmarrjes për të ardhmen duhet të orientohet kryesisht në zonat rurale dhe te konsumatorët që potencialisht janë konsumues të mëdhenj (pronat bujqësore dhe blegtorale, hotelet, kuzhinat-mensat, restorantet, industria ushqimore, industria ndërtimore etj). Zonimi i klientëve mundëson një situatë më të qëndrueshme duke marrë për bazë sasinë e ujit që hyn në zonë dhe sasisë që faturohet.

3.2.3. Standardizimi i matësve

Në fund të vitit 2015, Departamenti i Meteorologjisë që punon në kuadër të Ministrisë së Tregëtisë dhe Industrisë ka miratuar standardet për njësitë matëse të ujit në Kosovë. Ndërmarrja do të përmbushë në tërësi këtë standard të Ministrisë së Tregëtisë dhe Industrisë. Kompania, në zbatim të dispozitave ligjore do të kujdeset që në tërësi të zbatojë normat ligjore lidhur me instalimin e matësve të ujit te të gjithë konsumatorët e rinj, përkatësisht ndërrimit të matësve të dëmtuar te konsumatorët ekzistues.

Është bërë funksionalizimi i punëtorisë për kalibrimin e matësve. Janë krijuar kushte solide për të ndërmarrë të gjitha aktivitetet e nevojshme në rastet kur ekziston një dyshim i bazuar përkatësisht kërkesë e palëve të interesit për verifikimin e sasisë që matet përmes njësive matëse.

Ndërmarrja zotohet që në vazhdimësi do të kujdeset që furnizimi me matës të jetë në përputhje me Udhëzimin Administrativ të MTI-së.

3.2.4. Eliminimi i gabimeve softuerike

Minimizimi i gabimeve njerëzore do të bëhet përmes implementimit të leximit të matësve përmes pajisjeve të dorës në vend të ditarëve në “hard copy” , aplikimi i pragjeve për mbingarkim apo nënvlerësim të konsumit etj

Minimizimi i gabimeve softuerike nënkupton ndërhyrjet për rritjen e efikasitetit të modulit përmes; Funksionalizimit të bartjes automatike të të dhënave midis paisjeve të dorës për leximin e konsumit dhe modulit të faturimit, kontrollimit të faturave me konsum 0 (zero), funksionalizimi i paralajmërimeve për raste ekstreme (mbingarkesë apo nënngarkesë e konsumit), funksionalizimi i faturimit on-line ka dhënë efektet e para pozitive.


3.3.Rritja e shkallës së arkëtimit në sektorin e amvisërisë

Shkalla e arkëtimit paraqet njërën ndër treguesit më të rëndësishëm të funksionalitetit të ndërmarrjes.Tendenca e rritjes së shkallës së arkëtimit në vazhdimësi përveç që krijon parakushte të zhvillimit tekniko teknologjik të ndërmarrjes nga njëra anë, gjithashtu drejtpërdrejt ndikon edhe në tarifa të shërbimit më të ulta nga ana tjetër.

Mbi bazën e fakteve se kategoria e konsumatorëve të amvisërisë konsumojnë saktësisht 78,65 % të sasisë së ujit të faturuar na bënë të konstatojmë se kjo kategori është substanciale për të ardhmen e ndërmarrjes. Këtë e mbështesim edhe në faktin se ARRU përmes përcaktimit të tarifave ka bërë me dije se diferenca midis tarifës së amvisërisë dhe tarifës joamvisëri do të shkojë drejt tendencës së zvogëlimit.

Për më shumë referoju tabelës në faqen numër 54 si dhe Treguesve operativ dhe financiar të performancës në faqen numër 69.

Optimizimin në përcaktimin e trendit të rritjes së normës mesatare të arkëtimit e bazojmë në tendencën e rritjes së vazhdueshme të kësaj shkalle për vitin 2016 dhe 2017 (mbase si refleksion i Ligjit për Faljen e Borxheve Publike). Kjo është paraqitur në grafikonin në vijim është objektivi kryesor i ndërmarrjes krahas rritjes së kualitetit të shërbimeve ndaj konsumatorëve (ndërtimi i Fabrikës së Trajtimit të Ujit në Shkabaj).



3.3.1. Eliminimi i faturimit paushall (aforfe)

Mbi bazën e analizës së prezentuar në Bilancin e ujit, konstatohet se faturimi i shërbimeve bazë bëhet kryesisht në bazë të konsumit të matur. Kjo na jep të drejtën të konstatohet se konsumi i matur në kategorinë e konsumatorëve të bizneseve të vogla, bizneseve të mëdha dhe institucioneve është i kënaqshëm. Ndërmarrjes i mbetet që aktivitetin e vet ta përqëndrojë në sektorin e amvisërive.

Kuadri ligjor që rregullon çështjen e furnizimit me ujë dhe mënyrën e faturimit dhe pronësisë së instrumenteve matëse përcakton qartë afatet e vlershmërisë së instrumenteve matëse dhe pronësinë e tyre. Ujëmatësi është pronë e konsumatorit sepse me Tarifën aktuale konsumatori paguan për instalimin e matësve.

Tendenca e ndërrimit të matësve është një çështje e vazhdueshme kurdo që konstatohet prishja, dëmtimi apo vjetërsimi i matësit.

3.3.2. Verifikimi i saktësisë së leximit të matësve

Aktivitetet e filluara në tremujorin e katërt të vitit 2017 lidhur me verifikimin e saktësisë së leximit të matësve, duke përfshirë barazimin e gjendjes reale të matësve dhe gjendjes në bazën e të dhënave në softuerin zyrtar, varësisht nga analiza dhe përfitimet do të vazhdojnë edhe në vitin 2018.

Gjithashtu, fokusi akoma më i madh do të jetë edhe te kategoria e amvisërisë duke nisur nga fakti se 78,54 % e ujit që faturohet konsumohet në këtë sektor.

3.4. Rritja- zgjerimi i zonës së shërbimit- furnizimit me ujë të pijes (mbulimi i tërësishëm i zonës)

Fondet e mbetura për investime kapitale nga kryerja e veprimtarisë aktualisht janë të pamjaftueshme për zgjerimin e rrjetave të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të zeza. Megjithatë zhvillimi i hovshëm i lokaliteteve në zonën e shërbimit veçanërisht qyteti i Prishtinës dhe Fushë Kosovës gjithnjë ka nevojë për shtrirje të rrjetave.

Zgjerimi i rrjetit të furnizimit aktualisht mund të themi se zhvillohet në këto drejtime:

Financimi përmes fondeve të brendshme të lira (janë elaboruar në listën e investimeve kapitale)

Financimet nga komunat (do të zhvillohen diskutime me secilën komunë veç e veç)

Financimet nga donatorët (shpjegimet në vijim)

Financimet nga komuniteti (aktualisht të panjohura)

KRU “Prishtina” sh.a. bashkë me Programin Mbështetës për Ujë dhe Kanalizim në Zona Rurale (RËSSP) Faza e V- që është Program i bashkë-financuar nga Qeveria e Zvicrës përmes Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) Zyra në Kosovë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës përmes Ministrisë së Financave do të punojnë ngushtë për funksionalizimin e projekteve të miratuara.

Zbatimi i këtij Programi është ndërmarrë nga Konzorciumit Dorch & CDI. Investimi ka për qëllim të sigurojë furnizim me ujë të pijshëm të sigurt dhe infrastrukturë sanitare në komunitetet rurale.

Investimet që janë të planifikuara do të bëjnë zgjerimin e furnizimit me ujë të pijes në këto Komuna/Lokalitete.

- Komuna e Drenasit(Gllogocit),
- Komuna e Lipjanit,
- Komuna e Graçanicës,
- Komuna e Shtimes

Sistemet e reja edhe nëse këto sisteme janë të sapo ndërtuara apo rehabilituara sipas Programit, më pas transferohen në Kompanitë përkatëse Rajonale të Ujësjellësit për menaxhimin e qëndrueshëm operacional.

Ndërmarrja zotohet se do të kërkojë dhe harmonizoj nga Komunat planet investive në rrjetin e ujit dhe ujërave të zeza në bazë të Kornizës afatmesme të shpenzimeve 2018-2020.

Planifikimet për ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza është përgjegjësi e Komunave se ku planifikohen ndërtimet e reja dhe zgjerimet e kësaj infrastrukture. KRU “Prishtina” sh.a. ka për obligim pas ndërtimit të marrë në operim dhe mirëmbajtje.

3.5. Instalimi i matësve inteligjent (smart)

Aktualisht të gjithë matësit e ujit për të gjithë konsumatorët dhe të gjitha madhësive (profileve) janë matës klasik, të cilët nuk kontrollohen, lexohen dhe dirigjohen nga një qendër. Zhvillimi i teknologjive të reja në këtë fushë, ka mundësuar që me investime jo shumë të mëdha të fillohet me e përcjellë këtë trend të zhvillimit.

Përveç kontrollit të sasisë së ujit të shpenzuar instalimi i matësve të tillë mundëson edhe një shkallë 100 % të arkëtimit të faturave nëse e njëjta avancohet edhe me pagesën e paradhënies (pree paid). Paraprakisht softueri i matësve inteligjent nënkupton blerjen me parapagim të sasisë së ujit nga ana e konsumatorëve. Natyrisht konsumi i “kreditit” në matës mbyll automatikisht valvolat e furnizimit.

Zgjidhjet softuerike janë shumë të ndryshme.

Në këtë Plan të Biznesit, për periudhën 3 vjeçare janë parashikuar fonde nga burimet vetanake në vlerë 480.000 € për pilotimin e një zone, përkatësisht një kategorie të caktuar të konsumatorëve.

Aktualisht ndërmarrja është furnizuar me një sasi prej 900 njësive të tilla, e të cilët gjatë vitit 2017 do të nisë montimi për klientët e klasifikuar.

3.6. Integrimi i rrjetit shpërndarës të ujit

Funksionalizimi i fabrikës së përpunimit të ujit të pijes në Shkabaj, njëkohësisht nuk është shoqëruar edhe me masa të tjera infrastrukturore për të përmbushur kërkesën për ujë në një pjesë të zonës së shërbimit aty ku teknikisht lejon një gjë të tillë. Rritja e sasisë së ujit ka shkaktuar një tepricë të ujit të gatshëm për pije në Prishtinë, ndërkaq kjo nuk ndodh në qytetet afër Prishtinës siç janë Fushë Kosova dhe Obiliqi si dhe fshatrat e këtyre dy komunave. Kjo nuk ndodh për shkak se nuk ekziston një integrim i plotë midis sistemit të shpërndarjes së Prishtinës me Obiliqin dhe Fushë Kosovën.

3.6.1. Integrimi me rrjetin shpërndarës të Obiliqit

Furnizimi i pjesës dërmuese të konsumatorëve të Komunës së Obiliqit furnizohen nga pusët dhe stacioni i pompave në lokacionin “Hashanët”. Kapaciteti prodhues i këtyre është i limituar dhe problemi i furnizimit është jo në nivel të kënaqshëm. Edhe cilësia e ujit është në nivel më të ulët në krahasim me zonën tjetër të shërbimit.

Kosto e nxjerrjes dhe distribuimit të ujit nga këto puse është e lartë dhe për pasojë dëmtim të likuiditetit të ndërmarrjes.

Konsumatorët në zonën e Komunës së Obiliqit kanë mesatare të lartë të konsumit shprehur në m³. Megjithatë kjo është kryesisht e një furnizimi cilësor vetëm për pjesën që është e integruar me rrjetin shpërndarës të Prishtinës (shumica e fshatrave dhe pjesët e qytetit që janë afër Kapaciteteve energjetike të KEK-ut).

Integrimi i rrjetit është i lehtë sepse kjo mund të bëhet drejtpërdrejtë nga fabrika e ujit në Shkabaj që ka kapacitete të mjaftueshme.

Konzervimi i stacionit të pompave që ka kosto të lartë drejt shfrytëzimit të ujit nga fabrika në Shkabaj që ka kosto më të ulët do të rriste likuiditetin e ndërmarrjes, përkatësisht tarifa më të ulta të shërbimit ose mirëmbajtje më e avancuar e rrjetit shpërndarës në komunën e Obiliqit.

4. GJENDJA AKTUALE NË KRU "PRISHTINA" SH.A.

4.1. Gjendja e përgjithshme në KRU "Prishtina" sh.a.

Rekrutimi dhe përzgjedhja e menaxhmentit ekzekutiv gjatë vitit 2016 kanë pasur ndikimin pozitiv në relaksim të raporteve që paraprakisht ishin jashtë normales, gjendja e re e krijuar ka rezultuar me efekte pozitive në treguesit operativ dhe financiar dhe me tendencë të përmirësimit të të njëjtëve në kohën që interferon ky Plan i Biznesit.

Veprimet e natyrës operative përkatësisht financiare edhe administrative, që në mënyrë të vazhdueshme janë ndërmarrë për kryerjen e detyrave të punës, të shoqëruara edhe me masat tjera që ka ndërmarrë gjatë vitit 2017, mund të përmbledhen si :

Tendencë për :

Fillimi i punës testuese dhe operimit të rregullt në fabrikën për trajtimin e ujit në Shkabaj (pjesë e programit Prishtina III)

Lëshimi në funksion i filtrave të rinj në fabrikën e trajtimit të ujit në Badovc (pjesë e programit Prishtina II)

Furnizim cilësor dhe sasior me ujë të pijes, përmbushje e planit të prodhimit në vlerë absolute prej sasisë së prodhimit 105 % të planit, që do të thotë 2.612.916 m³ ujë më shumë.

Furnizimin me ujë të cilësisë sipas Direktivës Evropiane për ujë të pijes për të gjithë konsumatorët në zonën e shërbimit.

Mirëmbajtja e rrjetit primar dhe sekondar të ujësjellësit

Mirëmbajtja e rrjetit primar dhe sekondar të ujërave të ndotura

Kujdes i shtuar në ripërthritjen e bazës materiale të ndërmarrjes.

Mbajtja e nivelit të njëjtë në vlerë financiare përkatësisht në tendencë të rritjes së arkëtimit të faturave,

Përmbushja e planit të të hyrave deri në shkallën 99 %

Përmbyshja planit të arkëtimit 87.20 %

Rritjen e numrit të konsumatorëve të kyçur në rrjetin e furnizimit,

Shërbime administrative më të mira ndaj konsumatorëve

Implementimi i Ligjit mbi Faljen e Borxheve Publike etj.

Ndërrimi i skemës organizative

Fillimi i Projektit për verifikimin e leximit të matësve dhe korigjimet e Bazës së të dhënave duke marrë për bazë gjendjen faktike.

Aplikimi për Tarifën e shërbimit për ciklin tarifar 2018-2020.

Këta, janë treguesit kryesor me të cilën matet vlera e shërbimeve të ofruara përkatësisht matet performanca për vitin 2017 do të listohen dhe analizohen.

4.1.1. Performanca e përgjithshme e Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit “Prishtina” sh.a. gjatë vitit 2017

4.1.2. Performancat financiare gjatë vitit 2017

Deri në përfundim të vitit 2017 ndërmarrja pretendon që të përmbyshë dhe përmirësojë shumë nga treguesit e performancës në të cilët është vërejtur një ngecje (sasia e ujit të faturuar etj). Analiza e performancës financiare sipas treguesve kryesor por njëkohësisht edhe të analizave tjera që lidhen me vitin aktual si dhe rezultatet krahasuese janë bërë duke marrë për bazë rezultatet faktike për periudhën janar- gusht 2017 dhe vlerave të planifikuara për periudhën shtator- dhjetor 2017.

Vlera totale e shitjes së shërbimeve bazë përkatësisht faturimeve të shërbimeve të ujit dhe ujëra të zeza përfshirë edhe të hyrat nga taksa fikse e shërbimit, më 31.12.2017 do të jenë 14.292.501 €. Ndërsa vlera e planifikuar sipas Planit të Biznesit për vitin 2017 që ka qenë e planifikuar 14.458.197 €.

Në Planin e Biznesit është ka qenë i planifikuar faturimi i sasisë prej 22.205.077 m³ ujë, ndërsa deri në fund të vitit 2017 do të arrihet të faturohet jo më shumë se 22.038.235 m³. Shprehur në vlera relative kjo paraqet vetëm 99 % e përmbyshjes së Planit të Biznesit.

Në përfundim të vitit 2017 vlera totale e të hyrave të arkëtuara nga shërbimet bazë të ujit dhe kanalizimit janë 12.460.954 €. Me këtë rast e shohim të domosdoshme të theksojmë se

arkëtimi i planifikuar në vlerë prej 12.326.570 € është përmbushur dhe konstatojmë se vlera e parave të arkëtuara 12.460.954 €. Kjo vlerë është për 134.384 € më e madhe në krahasim me Planin e Biznesit. Shprehur në përqindje kjo është përmbushje e Planit të Biznesit deri në 101 %. Në bazë të rezultateve të realizuara në periudhën kur po përgatitet ky Plan i Biznesit një numër i këtyre treguesve është riparuar deri në përmbushje përkatësisht tejkalim (faturimi, arkëtim, kufizim i shpenzimeve etj)..

Intensifikimi i të gjitha aktiviteteve të ndërmarra nga menaxhmenti, kryesisht ZKF.

Rritje e përkushtimit të menaxhmentit dhe personelit tjetër për rritjen e shkallës së arkëtitimit në periudhën e mbetur e sidomos në sektorin e amvisërisë.

Gjithashtu edhe në sektorin e bizneseve të vogla (lokalet) të intensifikohen aktivitetet për përmirsimin e shkallës së arkëtitimit.


Ka vazhduar trendi i rritjes së numrit të konsumatorëve

Shkalla e humbjeve teknike dhe administrative në fund të vitit do të jetë mbi parashikimet. Kjo ndodh nga fakti i futjes në sistemin e shpërndarjes së një sasive shumë të madhe të ujit (FPU në Shkabaj).

Rishikimi i sasisë së ujit të faturuar do të bëhet përmes verifikimit të saktësisë së faturimit kryesisht në Prishtinë me Projektin e verifikimit sipas të cilit do të punësohen 45 lexues për një periudhë kohore tetor, nëntor dhe dhjetor 2017.

Nuk është arritur të bëhet ndarja-identifikimi midis humbjeve teknike dhe humbjeve administrative të ujit.

Shpenzimet operative do të sillen rreth vlerës prej 10.042.340 € dhe me trendin e tillë nuk do të kalojnë (do të jenë më të vogla) vlerën e planifikuar për 350.680 € përkatësisht 97 % nga vlera fillestare e planifikuar.



4.1.3. Performancat operative në vitin 2017

Performanca e përgjithshme operative që në fakt nënkupton: nxjerrjen, pastrimin dhe përpunimin e ujit të pijes, distribuimin e ujit, mirëmbajtjen e rrjetit primar dhe sekondar të ujit dhe ujërave të papërdorura, mirëmbajtjen energjetike dhe makinerike, mirëmbajtjen e pajisjeve të punës dhe aparaturave, duke përfshirë edhe zhvillimin dhe avancimin tekniko teknologjik të sistemit në tërësi:

Viti 2017, përkatësisht koha deri në të cilën po përgatitet ky Plan i Biznesit është karakterizuar me një situatë shumë të favorshme sa i përket rezervave të ujit nëpër liqenet akumuluese dhe në burimet nëntokësore në të gjithë zonën e shërbimit. Prandaj duke iu falënderuar kësaj situatë të favorshme të rezervave të ujit si dhe lëshimit në punë 3 muaj përpara se që ka qenë e planifikuar të fabrikës së ujit në Shkabaj, sasia optimale e planifikuar prej 49.746.010 m³ ujë është tejkaluar për 5 % përkatësisht është distribuuar 52.367.926 m³ ujë. Sasia e ujit të distribuuar në krahasim me planifikimin vjetor është më e madhe për 2.621.916 m³ ujë më shumë.

Muajt e stinës së verës, janë karakterizuar me temperatura larta, për pasojë konsumim shumë të lartë të ujit, duke përfshirë edhe shpërdorimin e ujit. Kjo situatë ka shkaktuar reduktime të herë pas here të ujit në zona me lartësi të mëdha mbidetare.

Nuk është plotësuar në tërësi kërkesa për ujë. Prandaj është aplikuar një sistem i kontrolluar i reduktimeve gjatë gjithë vitit 2017 e vecanësisht në periudhën e muajve të verës. Është arritur të bëhet një mirëmbajtje e rregullt e tërë sistemit të ujit të pijes dhe ujërave të zeza.

Kualiteti i ujit të distribuuar në tërë zonën e shërbimit iu është përgjigjur instruksioneve të Udhëzimit administrativ numër 16/2012 dhe është arritur të monitorohet dhe kontrollohet rregullisht kualiteti i ujit nga laborator i qendror dhe laboratorët lokal të KRU “Prishtina”-sh.a. Ankesat në kualitet të ujit kanë qenë minimale ndërsa bashkëpunimi me Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik ka qenë i nivelit më të lartë,

4.1.4. Performancat operative dhe financiare në vitin 2017

Në tabelën vijuese po paraqesim përmes shifrave disa nga treguesit e performancës për vitin 2017. Këta tregues janë vënë në raport me vitin paraprak si dhe me Planin e Biznesit për vitin 2017.

Treguesit njëkohsisht janë pasqyruar në vlerë absolute (sasi- m³, vlerë- € dhe numër- #) si dhe në vlerë relative (përqindje- %) duke vënë në raport vitin aktual me vitin paraprak dhe vitin aktual me Planin e Biznesit.

Treguesit e zgjedhur për prezentim konsiderohen si më të rëndësishmit për të pasqyruar efikasitetin e ndërmarrjes duke marrë në konsideratë prodhimtarinë, shkallën e humbjeve teknike e administrative, numrin e konsumatorëve, normën e arkëtimit, normën e mbulimit të punës etj).

Pasqyra krahasuese e disa nga treguesit e performancës për 2016 dhe 2017

Treguesit e performancës		Faktike 2016	2017		Index	
			Plani	Faktike	Faktike 2017/16	Faktike 2017/ Plan 2017
Uji i Prodhuar	m ³	44,846,198	49,746,010	52,367,926	111%	105%
Uji i faturuar	m ³	21,215,821	22,912,993	21,989,501	108%	96%
Uji i pafaturuar	m ³	23,630,377	26,833,017	30,378,425	114%	113%
Konsumatorë të shërbyer	#	123,142	130,744	127,909	106%	98%
Vlera e faturimit	#	13,431,980	14,458,121	14,292,501	108%	99%
Vlera e arkëtimit	€	12,406,085	12,335,826	12,460,954	99%	101%
Të hyra të tjera operative	€	656,592	222,430	273,685	34%	123%
Shpenzimet operative	€	8,973,963	10,393,020	10,042,340	116%	97%
Borxhet e paarkëtuara	€	1,025,895	2,122,295	1,831,547	207%	86%
Numri i punëtorëve	#	543	550	545	101%	99%
Shkalla e inkasi. (% e tere)	%	92%	85%	87%	92%	102%
Norma e punës	%	1.38	1.19	1.24	86%	105%
Konsumatorët për punëtorë	€	227	238	217	105%	91%
Shpenzi. Operat. për kons.	€	73	79	79	109%	99%
Tarifat mesatare për m3 (prodhimi)	€	0.30	0.29	0.27	97%	94%
Tarifat mesatare për m3 (prodhimi)	€	0.63	0.63	0.65	100%	103%

4.1.5. Performanca administrative në vitin 2017

Bordi i drejtorëve, me qëllim të rritjes së shkallës së sasisë së ujit të faturuar, përkatësisht eliminimit të humbjeve komerciale të ujit, ka marrë vendim që të punësohen për një periudhë të caktuar kohore (kontratë tre mujore) 45 punëtorë. Në bazë të planit të veprimit të miratuar nga menaxhmenti këta punëtorë do të punojnë në drejtim të verifikimit të gjendjes në teren (pronën e konsumatorit) me këto detyra dhe përgjegjësi:

Vizitë të detyrueshme në pronën e konsumatorit,

Leximi i konsumit të ujit sipas matësit dhe numrit serik të matësit

Identifikimin e konsumatorit, duke përfshirë numrin e dokumentit identifikues përkatësisht numrin e telefonit.

Krahasimi i të dhënave midis gjendjes faktike dhe gjendjes së matësit

Vlerësim i përafërt i gjendjes së matësit dhe gjendjes së pusetës

Transferimi i shënimeve nga regjistri “hard copy” në regjistrin elektronik.

Punë të tjera që nuk janë në kundërshtim me përgatitjen profesionale dhe nuk dëmtojnë shëndetin e punëtorit.

Plani i veprimit për këtë është i koncentruar në Prishtinë. Gjatë krahasimit të të dhënave nëse menaxhmenti e sheh si një veprim me vlerë dhe të rëndësishëm i njëjti do të zhvillohet edhe nëpër të gjitha njësitë.

5. STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE PLANIFIKIMI I PERSONELIT

5.1.1. Struktura organizative

KRU “PRISHTINA” sh.a. është kompani publike regjionale – përkatësisht ndërmarrje e korporatizuar. Ndërmarrja më 01.07.2007 është organizuar në cilësinë e shoqërisë akcionare. Kapitali akcionar vlerësuar në 25.000 akcione, të gjitha në vlerë nominale prej 1 € për cdo akcion. Në pajtim me Ligjin mbi Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin mbi Shoqëritë Tregëtare (cituar më lartë), Qeveria e Republikës së Kosovës është pronare e vetme e të gjitha akcioneve të Kompanisë. Ministria për Zhvillim Ekonomik në emër të pronarit të aksioneve e ushtron kompetencën dhe përgjegjësinë në bazë të Ligjit, Statutit dhe akteve tjera nënligjore. Ushtrimi i këtyre kompetencave dhe përgjegjësi realizohet përmes Bordit të Drejtorëve dhe menaxhmentit

5.1.2. Struktura menaxhuese

Kompania menaxhohet drejtëpërdrejtë nga zyrtarët e lartë të kompanisë.

- Kryeshefi ekzekutiv
- Zyrtari Kryesor Financiar
- Sekretari dhe
- Auditori i brendshëm

Në vartësi të drejtëpërdrejtë të Kryeshefit Ekzekutiv gjithashtu është Drejtori Teknik si dhe zyrtarët e tjerë nënrenditës të zgjedhur (në pajtim me Ligjin e cituar). Menaxhimi kryhet edhe përmes bartësve të niveleve më të ulët: menaxherët ekzekutiv të departamenteve, shefat e


shërbimeve teknike dhe administrative, menaxherët e Njësive operative të ujësjellësve, shefat e fabrikave për trajtimin e ujit, koordinatorët, zyrtarët etj.

5.1.3. Skema organizative-organogrami

Skema organizative e KRU “Prishtina” sh.a. është e modelit të piramidës në delegimin e kompetencave, përgjegjësi dhe autorizimeve nga "lartë poshtë", kryerjen dhe raportimin e përmbushjes së të njëjtave nga "poshtë lartë".

Skema organizative aktuale është miratuar nga Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e mbajtur më 28.07.2017, vendimi nr. 2017/3 – 03.

Skema mund të ndryshojë vetëm në rast të ndryshimeve të domosdoshme që mund të bëjë aksionari (Qeveria e Republikës së Kosovës).



5.2. Planifikimi i personelit

5.2.1. Numri total i stafit administrativ dhe operativ

KRU "PRISHTINA" sh.a. në Prishtinë në periudhën ndërmjet viteve 2018-2020 (duke përfshirë edhe njësitë operative të konsoliduara) tërë procesin e përpunimit, shpërndarjes - distribuimit, shërbimit me ujë të pijshëm dhe mënjanimin e ujërave të ndotura do ta përmbyllë me mesatarisht 545 deri 560 punëtorë (maksimalisht- periudha e funksionalizimit të fabrikës së trajtimit të ujit në Shkabaj).

Raportet, përgjegjësitë, detyrimet dhe kompetencat midis stafit janë të përcaktuara mbi bazë të Skemës organizative dhe Rregullores mbi sistematizimin dhe organizimin e brendshëm duke përfshirë edhe përshkrimin detaj të vendeve të punës.

Personeli që kryen punët dhe detyrat në KRU "Prishtina" sh.a. është heterogjen:

- Nga aspekti i përgatitjes profesionale;
- Nga aspekti i shkathtësive, produktivitetit dhe efikasitetit në punë;
- Nga aspekti i përfaqësimit nacional;
- Nga aspekti i përfaqësimit gjinor;
- Nga aspekti i përfaqësimit fetar;
- Nga aspekti social etj.

5.2.2. Struktura kualifikuese dhe gjinore

Personeli i KRU "Prishtina" sh.a në aspektin e përgatitjeve shkollore, kompetencave dhe përgjegjësi është shumë heterogjen. Prandaj kjo diferencë e bënë të vështirë rritjen e shkallës së produktivitetit dhe menaxhimit më të mirë të personelit.

Në vazhdim është paraqitur tabela e kualifikimeve dhe certifikatave shkollore për të gjithë të punësuarit si dhe struktura gjinore e personelit.

Emërtimi	Struktura kualifikuese										Totali
	PSP-master	PSP	PLP-master	PLP	PMP	Sh.F.	K. Lartë	GJ.Kualifikuar	Diplomë, çertifikatë	Shofer i kategorive të ndryshme	
Meshkuj	10	38	14	45	294	20	4	24	26	17	492
Femra	3	13	3	14	32	2	0	0	1	0	68
Totali	13	51	17	59	326	22	4	24	27	17	560
Struktura-meshkuj në %	77%	75%	82%	76%	90%	91%	100%	100%	96%	100%	88%
Struktura-femra në %	23%	25%	18%	24%	10%	9%	0%	0%	4%	0%	12%

5.2.3. Struktura nacionale

Zona e shërbimit të KRU "Prishtina" sh.a. edhe nga aspekti i përbërjes nacionale është mjaft heterogjen. Në vazhdimësi i është kushtuar kujdes edhe përfaqësimit nacional.


Struktura nacionale është paraqitur në tabelën në vijim.

Emërtimi	Struktura nacionale					Totali
	shqiptar	serb	boshnjak	turq	rom	
Punëtorë	532	25	1	1	1	560
Struktura në %	95.00%	4.46%	0.18%	0.18%	0.18%	100%

5.2.4. Struktura moshës së personelit

Mosha mesatare e personelit të punësuar në KRU "Prishtina" sh.a. është 47 vjeç. Kjo konsiderohet si një moshë kritike dhe sinjal për ripërtrirjen e personelit.

Në grafikonin e mëposhtëm është pasqyruar mosha e personelit sipas grupmoshave.



Nga tabelat dhe grafikonet e prezantuar shohim heterogjenitetin e të punësuarve si dhe strukturën individuale nacionale në totalin e të punësuarve.


Kompensimi i pagës për punën, për të gjithë personelin, konsiderojmë se iu është qasur në mënyrë komplekse dhe gjithëpërfshirëse. Të gjithë të punësuarit përveç pagës bazë iu kompensohet edhe bonusi për ushqimin ditor dhe shtesat tjera që derivojnë nga Ligji i Punës dhe Kontrata Kolektive

Gjithashtu edhe trajnimit të vazhdueshëm të stafit i kushtohet një kujdes i veçantë ndërsa kosto e këtyre është paraqitur në buxhetin e përgjithshëm në kategorinë e shpenzimeve të personelit.

5.2.5. Numri i personelit në raport me numrin e konsumatorëve

Një kujdes i veçantë do t'i kushtohet çështjes së raportit midis numrit të personelit të nevojshëm për kryerjen e detyrave të punës dhe numrit total të konsumatorëve.

Tendenca e menaxhmentit përmes implementimit të këtij Planit të Biznesit është rritja e produktivitetit në punë përkatësisht zvogëlimi i numrit të personelit në raport me numrin e konsumatorëve (e llogaritur për punëtor) .



Grafikoni paraprak na tregon se numri i konsumatorëve është rritur në trend më të madh në krahasim me rritjen e numrit të punëtorëve. Në vitin 2011 shohim se ka qenë i punësuar mesatarisht 1 punëtor për 198 konsumatorë. Tendenca e rritjes së konsumatorëve prej vitit në vit është treguesi më i mirë i rritjes së vëllimit të punës për një pjesë të personalit përkatësisht rritja e produktivitetit në punë. Në përfundim të periudhës së këtij Planit të Biznesit pritet të jetë rreth 300 konsumatorë për një punëtor.

6. BUXHETI I KRU “PRISHTINA” SH.A.

Buxheti i KRU "Prishtina" sh.a. reflekton në mënyrë të plotë dhe domethënëse politikën financiare edhe operative të menaxhimit të të gjitha proceseve të punës. Përmban instrumentin kryesor të aktivitetit ekonomik të ndërmarrjes dhe zë një vend madhor në strukturën e gjithëmbarshme të Planit të Biznesit për periudhën 2018-2020.

Buxheti si një akt, përcakton të gjitha linjat e të ardhurave, shpenzimeve dhe investimeve të ndërmarrjes brenda një viti.

6.1. Buxheti vjetor për vitin 2018 dhe parashikimet për periudhën 2019 - 2020

Buxheti është i balancuar në termat e arkëtimeve (të hyrave nga shërbimet e ofruara ndaj klientëve) dhe të pagesave (shërbimet e pranuar nga palët e treta). Të gjitha arkëtimet dhe pagesat e ndërmarrjes kryhen nëpërmjet llogarisë së unifikuar të thesarit, e mbajtur në euro. Llogaritë e unifikuara të thesarit mbahen në Bankat komerciale të certifikuara nga Banka Qendrore e Kosovës.

Në tabelën në vijim mbi baza vjetore janë paraqitur kategoritë të cilat përbëjnë në esencë veprimtarinë themelore të ndërmarrjes.

Buxheti vjetor 2018 – 2020

Elementet			Buxheti 2018	Projektuar 2019	Projektuar 2020
Të hyrat	Kategorizimi i të ardhurave				
	1	Të hyrat e arkëtuara	14,486,682	14,783,796	15,382,753
	2	Të hyrat tjera	314,638	330,370	346,888
	3	Të ardhurat bruto (1+2)	14,801,320	15,114,166	15,729,641
Kategoritë e shpenzimeve					
Shpenzimet	4	Vlera ujit të papërpunuar	657,650	683,955	711,312
	5	Shpenzimet e energjisë	2,900,647	3,016,673	3,137,340
	6	Shpenzimet e karburanteve	156,000	154,300	152,500
	7	Shpenzimet e personelit	5,040,287	5,175,287	5,310,287
	8	Shpenzimet materiale	699,212	727,180	756,267
	9	Shërbimet e jashtme kontraktuese	752,781	782,892	814,208
	10	Shpenz.rekreac.sportit ndihmave solidare	-	13,200	15,300
	11	Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit	90,076	93,679	97,427
	12	Të dalurat financiare / transferi i rezultatit financiar	48,100	51,000	54,001
	13	Totali i shpenzimeve operative (4deri 13)	10,344,752	10,698,165	11,048,642
Rezerva financiare			410,568		
Diferenca e arkët. & shpenz.			4,046,000	4,416,000	4,681,000
Investimet kapitale			1,324,000	1,694,000	1,959,000
Pagesa e kryegjësë dhe interesit			2,722,000	2,722,000	2,722,000
Mbetja neto			-	-	-

6.2. Buxheti mujor për vitin 2018

Menaxhmenti, gjatë planifikimit të biznesit, ka qenë në kujdes të vazhdueshëm rreth trajtimit të kategorisë së të hyrave dhe kategorisë së shpenzimeve duke pasur në konsideratë edhe që kategoria e shpenzimeve në cdo muaj të jetë më e vogël se kategoria e të hyrave, duke realizuar një diferencë pozitive dhe tepriçë e të ardhurave të mbetura.

Në tabelën në vazhdim në baza mujore është paraqitur në mënyrë analitike të hyrat e arkëtuara sipas katër kategorive të konsumatorëve duke përfshirë edhe të hyrat nga shërbimet dytësore që bënë ndërmarrja ndaj palëve të treta.

Përkushtimi për përmbushjen e objektivave të parashikuara në Buxhetin e ndërmarrjes garantojnë një likuiditet të ndërmarrjes dhe siguri të vazhdimësisë së veprimtarisë.

KOMPANIA RAJONALE UJËSJELLËSI “PRISHTINA” SH.A

Elementet	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Arkëtimi-amvisëritë	651,987	595,350	667,313	665,711	701,788	718,292	798,144	837,820	790,659	784,290	770,008	818,964
Arkëtimi-BV	122,737	113,511	125,653	125,512	131,745	134,984	148,700	155,764	148,166	147,261	145,679	155,152
Arkëtimi-BM	115,639	102,364	116,158	114,520	120,539	122,989	137,836	144,645	134,077	131,372	128,021	137,479
Arkëtimi-institucione	195,169	172,203	195,385	192,304	202,390	206,484	231,995	243,474	224,711	219,408	213,337	228,994
Arkëtimi-shërbimet dytësore	28,796	26,814	28,372	24,295	20,462	24,281	25,690	26,409	27,562	27,491	25,665	28,801
Arkëtimi-Total	1,114,328	1,010,243	1,132,881	1,122,341	1,176,924	1,207,029	1,342,366	1,408,112	1,325,175	1,309,821	1,282,710	1,369,390
Shp. e ujit	55,710	52,116	55,710	53,916	55,710	53,917	56,667	56,667	55,710	52,116	53,916	55,493
Shp. e energjisë	252,067	246,567	247,951	252,248	240,220	231,790	229,778	228,775	232,026	241,574	240,022	257,629
Shp. e karburanteve	13,647	14,287	13,378	12,678	9,608	12,647	12,198	9,964	11,598	12,533	15,536	17,927
Shp. e personelit	405,380	391,025	410,049	404,196	416,297	394,186	415,815	397,586	412,260	397,788	413,108	582,598
Shp. e materialit	87,015	40,694	37,413	43,187	29,234	37,631	62,627	29,364	80,112	36,993	115,035	99,907
Sherb. Kontraktuese	38,309	53,020	71,430	47,281	49,129	62,279	114,896	74,571	57,791	41,924	73,510	68,641
Shp. ndih. soli.												
Shp. mirëmb.& ripar.	80	4,628	3,100	16,841	7,327	9,057	3,953	6,001	9,077	3,629	12,412	13,972
Shp. tjera finan.	4,127	4,038	9,316	4,474	10,982	514	1,401	2,151	2,588	1,717	1,292	5,500
Total shp. operat.	856,335	806,374	848,348	834,821	818,507	802,021	897,335	805,079	861,160	788,274	924,831	1,101,667
Diferenca e arkët. & shpenz.	257,993	203,868	284,533	287,520	358,417	405,008	445,031	603,033	464,014	521,547	357,878	267,723

6.3. Buxheti- arkëtimet, shpenzimet, investimet kapitale dhe mbetja neto

Elementet	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
Arkëtimi	1,114,328	1,010,243	1,132,881	1,122,341	1,176,924	1,207,029	1,342,366	1,408,112	1,325,175	1,309,821	1,282,710	1,369,390	14,801,320
Shpenzimet	856,335	806,374	848,348	834,821	818,507	802,021	897,335	805,079	861,160	788,274	924,831	1,101,668	10,344,753
Mbetja financiare	257,993	203,868	284,533	287,520	358,417	405,008	445,031	603,033	464,014	521,547	357,878	267,722	4,456,567
Mbetja e akumuluar	257,993	32,993	16,861	136,395	313,915	362,332	637,340	1,057,371	1,631,404	2,080,419	2,551,966	2,864,844	2,864,844
Investimet kapitale	225,000	220,000	165,000	110,000	310,000	130,000	25,000	29,000	15,000	50,000	45,000	-	1,324,000
Mbetja neto	32,993	16,861	136,395	313,915	362,332	637,340	1,057,371	1,631,404	2,080,419	2,551,966	2,864,844	3,132,568	-

6.4. Faturimet dhe arkëtimet e shërbimeve bazë

Të hyrat që rezultojnë nga transaksione të ndërsjella dhe jo të ndërsjella, të ardhurat nga shitja e shërbimeve të ujit dhe ujërave të zeza, shërbimeve tjera sekondare dhe terciare në bazë të tarifës së aprovuar nga Autoriteti Rregullator i Ujit të ardhurat nga taksat dhe tarifat, nga grantet dhe donacionet nga palët e treta, nga interesat, nga transaksionet financiare. Gjatë vitit 2018 vlera totale e faturimeve të shërbimeve bazë do të sillet rreth 15.999.065 € duke përfshirë njëkohsisht edhe të hyrat nga veprimtaria dytësore në vlerë prej 314.638 €.

Fatkeqësisht, nërmarrjet publike përkatësisht të hyrat publike në Republikën e Kosovës njëjtë sikurse edhe në ndërmarrjen e ujësjellësit nuk po arkëtohen në shkallën optimale. Ndikim themelor në mos arkëtimin e tërësishëm të faturave të shërbimeve të ujit dhe kanalizimit kanë konsumatorët e klasifikuar si përfitues të skemave sociale, rregullativa ligjore që pamundëson shkyçjen nga rrjeti i furnizimit objektet e banimit kolektiv dhe fshatrat në zonën e shërbimit.

Këto të hyra të faturuara vështirë arkëtohen, prandaj norma e arkëtimit pritet të jetë rreth 90.55 % përkatësisht 14.486.682 € vlerë e arkëtuar.


Në tabelën, në vijim janë paraqitur të hyrat e faturuara në baza mujore sipas kategorive të konsumatorëve nga njëra anë si dhe arkëtimeve mujore gjithashtu sipas kategorive të konsumatorëve,

Norma- përqindja e arkëtimit është nxjerrë si raport i vlerës së të ardhurave të arkëtuara dhe vlerës së faturimit për çdo kategori ndaras por edhe në total të ndërmarrjes.

Tabela mujore e faturimit, arkëtimit dhe norma e përmbushjes për vitin 2018


Elementet	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
Faturimi-amvisëri	788,817	712,479	790,050	778,537	812,774	823,854	906,599	942,583	881,313	866,935	846,264	898,125	10,048,330
Faturimi-BV	144,397	132,181	144,833	143,220	148,836	150,982	164,662	170,787	160,931	158,467	155,308	163,837	1,838,440
Faturimi-BM	120,457	106,408	120,496	118,551	124,524	126,793	141,807	148,506	137,374	134,327	130,634	139,999	1,549,875
Faturimi-Institucione	199,152	175,538	198,967	195,629	205,681	209,628	235,290	246,681	227,441	221,848	215,492	231,073	2,562,419
Faturimi-Total	1,252,823	1,126,606	1,254,345	1,235,937	1,291,814	1,311,257	1,448,357	1,508,557	1,407,058	1,381,578	1,347,697	1,433,035	15,999,065
Norma arkëtimit-amvis.	82.65%	83.56%	84.46%	85.51%	86.34%	87.19%	88.04%	88.89%	89.71%	90.47%	90.99%	91.19%	87.58%
Norma arkëtimit-BV	85.00%	85.88%	86.76%	87.64%	88.52%	89.40%	90.31%	91.20%	92.07%	92.93%	93.80%	94.70%	90.01%
Norma arkëtimit-BM	96.00%	96.20%	96.40%	96.60%	96.80%	97.00%	97.20%	97.40%	97.60%	97.80%	98.00%	98.20%	97.15%
Norma arkëtimit-Instit.	98.00%	98.10%	98.20%	98.30%	98.40%	98.50%	98.60%	98.70%	98.80%	98.90%	99.00%	99.10%	98.57%
Norma mesatare arkëtimit	86.65%	87.29%	88.05%	88.84%	89.52%	90.20%	90.91%	91.59%	92.22%	92.82%	93.27%	93.55%	90.55%
Arkëtimi-amvisëritë	651,987	595,350	667,313	665,711	701,788	718,292	798,144	837,820	790,659	784,290	770,008	818,964	8,800,324
Arkëtimi-BV	122,737	113,511	125,653	125,512	131,745	134,984	148,700	155,764	148,166	147,261	145,679	155,152	1,654,864
Arkëtimi-BM	115,639	102,364	116,158	114,520	120,539	122,989	137,836	144,645	134,077	131,372	128,021	137,479	1,505,640
Arkëtimi-nstitucione	195,169	172,203	195,385	192,304	202,390	206,484	231,995	243,474	224,711	219,408	213,337	228,994	2,525,854
TOTAL ARKËTIMI	1,085,532	983,429	1,104,509	1,098,046	1,156,462	1,182,748	1,316,676	1,381,703	1,297,613	1,282,330	1,257,045	1,340,589	14,486,682

Në vazhdim, në grafikun është paraqitur trendi mujor i faturimit dhe arkëtimit të faturave nga shërbimet bazë duke paraqitur njëkohësisht edhe normën e arkëtimit. Norma është si rezultat i raportit në mes të vlerës mujore të faturimit dhe vlerës totale të arkëtimit- përfshirë edhe arkëtimet e faturave nga muajt paraprak por që ekskluzivisht janë arkëtuar në muajin e raportuar.



6.5. Struktura e faturimit sipas kategorive për vitin 2018


Në grafikun e mëposhtëm është paraqitur struktura e të hyrave të faturuara për vitin 2018. Të hyrat që pritet të faturohen për shërbimet bazë për vitin 2018 janë në vlerë prej 15.999.065 €. Shpërndarja nëpër kategoritë përkatëse është paraqitur si më poshtë.



6.6. Struktura e arkëtimeve sipas kategorive për vitin 2018

Në grafikun e mëposhtëm është paraqitur struktura e të hyrave të arkëtura për vitin 2018. Të hyrat që pritet të arkëtohen për vitin 2018 janë në vlerë prej 14.486.682 €

Shpërndarja nëpër kategoritë përkatëse është paraqitur si më poshtë.



6.7. Shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes

6.7.1. Shpenzimet mujore të operimit dhe të mirëmbajtjes për vitin 2018

Kryerja e të gjitha veprimeve të prodhimtarisë dhe operative përfshirë edhe ato administrative e financiare nënkupton disponueshmërinë e fondeve të mjaftueshme. Viti 2017 në ndërmarrje është shoqëruar me ndryshime të mëdha në rritjen e kapaciteteve prodhuese, prandaj edhe historiku i deritanishëm nuk mjafton për të parashikuar edhe për vitet e ardhshme.

Të klasifikuara si shpenzime të operimit dhe të mirëmbajtjes, përfshirë të gjitha ato që lidhen me transaksione të ndërsjella dhe jo të ndërsjella, të emëruara si: shpenzime të personelit, shpenzime për blerjen e mallrave dhe shërbimeve, blerja e shërbimeve të ndryshme kontraktuale (taksa, anëtarësi, telefoni, internet, taksa gjyqësore etj), pagesa financiare dhe të principaleve të borxhit, shpenzime për interesa, shpenzime për qira financiare.


Shpenzimet e operimit dhe të mirëmbajtjes të kategorizuara (përfshirë dakordimin paraprak me ARRU-në dhe të gjitha ndërmarrjet tjera të ujësjellës & kanalizimeve në Republikën e Kosovës), në baza mujore që janë planifikuar sipas muajve janë paraqitur në tabelën në vijim. Vlera totale e këtyre shpenzimve në baza mujore është 10.344.752 €.

Menaxhmenti i KRU “Prishtina” sh.a. do të jetë i kujdeshëm, të fokusojë vëmendjen edhe aktualitetit ekonomik dhe zhvillimor në vend, në rajon. Përvojat e deritanishme të vendeve që kanë hyrë në recesion domosdoshmërisht na sinjalizojnë për ndërmarrjen e masave efikase të kursimit të vullnetshëm përkundër situatave shtënguese për kursim me të cilën mund të ballafaqohet ndërmarrja.

Tabela mujore e shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe operimit për vitin 2018

Kategoria e shpenzimeve	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Shp. e ujit	55,710	52,116	55,710	53,916	55,710	53,917	56,667	56,667	55,710	52,116	53,916	55,494
Shp. e energjisë	252,067	246,567	247,951	252,248	240,220	231,790	229,778	228,775	232,026	241,574	240,022	257,629
Shp. e karburanteve	13,647	14,287	13,378	12,678	9,608	12,647	12,198	9,964	11,598	12,533	15,536	17,927
Shp. e personelit	405,380	391,025	410,049	404,196	416,297	394,186	415,815	397,586	412,260	397,788	413,108	582,598
Shp. e materialit	87,015	40,694	37,413	43,187	29,234	37,631	62,627	29,364	80,112	36,993	115,035	99,907
Shërbimet Kontraktuese	38,309	53,020	71,430	47,281	49,129	62,279	114,896	74,571	57,791	41,924	73,510	68,641
Shp. ndih. soli.												
Shp. mirëmb.& riparimit	80	4,628	3,100	16,841	7,327	9,057	3,953	6,001	9,077	3,629	12,412	13,972
Shp. tjera finan.	4,127	4,038	9,316	4,474	10,982	514	1,401	2,151	2,588	1,717	1,292	5,500
Total shpenzimet op.	856,335	806,374	848,348	834,821	818,507	802,021	897,335	805,079	861,160	788,274	924,831	1,101,668

Grafikisht kjo kategori buxhetore është paraqitur në grafikun vijues duke nënvizuar pjesëmarrjen (strukturën) e çdo kategorie në shpenzimet totale të ndërmarrjes për vitin 2018.



6.7.2. Shpenzimet vjetore të operimit dhe të mirëmbajtjes për periudhën 2011-2020

Për qëllime të analizave në tabelën vijuese janë paraqitur kategorizimi i shpenzimeve të operimit dhe mirëmbajtjes për periudhën paraprake (2011) si dhe periudhën që e mbërthen ky Plani i Biznesit (2018-2020).

Tabela vjetore e shpenzimeve (historike dhe të parashikuara) të mirëmbajtjes dhe operimit për periudhën 2011-2020

Elementet	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Vlera furnizuese e ujit	88,957	94,596	88,796	257,524	93,268	93,523	412,110	657,650	683,955	711,312
Shpenzimet e energjisë	2,073,409	2,142,293	2,122,412	2,095,835	2,476,720	2,337,401	3,081,363	2,900,647	3,016,673	3,137,340
Shpenzimet e karburanteve	146,994	166,208	178,220	160,804	144,116	96,854	161,559	156,000	154,300	152,500
Shpenzimet e personelit	3,636,090	3,931,109	4,240,704	4,834,965	4,828,762	4,975,486	4,909,939	5,040,287	5,175,287	5,310,287
Shpenzimet materiale	665,335	646,121	634,109	651,525	668,213	715,475	676,682	699,212	727,180	756,267
Shërbimet e jashtme kontraktuese	461,610	834,766	741,942	827,381	707,507	711,803	623,808	752,781	782,892	814,208
Shpenzimet e rekreacionit, dhe ndihmave solidarë	6,627	16,669	8,003	6,831	14,050	9,249	10,340	-	13,200	15,300
Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit	106,589	97,504	86,596	151,425	145,992	93,171	92,486	90,077	93,680	97,427
Te dalurat financiare transferi i rezultatit financiar	475,273	158,078	44,471	60,528	28,684	16,751	51,472	48,100	51,000	54,000
Gjithsejt Shpenzimet Operative	7,660,884	8,087,344	8,145,253	9,046,818	9,107,312	9,049,713	10,019,758	10,344,753	10,698,166	11,048,641

6.8. Investimet kapitale në KRU “Prishtina” sh.a.

Politika aktuale e përcaktimit të tarifës së shërbimit merr në konsideratë edhe financimin e shpenzimeve kapitale përkatësisht ripërtitjen e aseteve të kompanisë. ARRU-u, tarifat aktuale i ka përcaktuar në bazë të projekteve të listuara për këtë periudhë. Projektet do të financohen nga diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes, granteve, donacioneve, kredive bankare, investimeve vetanake të komunave dhe komuniteteve. Marrja në konsideratë, nevojën për financimin e shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes gjithashtu financimi i investimeve kapitale paraqet sfidën dhe çështjen biznesore më të rëndësishme në KRU “Prishtina” sh.a.

Niveli i fondeve të nevojshme për financimin e investimeve kapitale do të jetë gjithnjë më i madh për aq sa kompania do të jetë e përgjegjshme për të shtuar sasinë e ujit që distribuon drejt konsumatorëve, rritjen e normës së ujit të faturuar, rritjen e normës së arkëtimit të shërbimeve dhe kufizimin e ngritjes së shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes.

Gjatë pjesës së mbetur të vitit 2017 dhe jo më vonë se në periudhën e parë gjashtëmuajore të vitit 2018, ndërmarrja do të trajtojë edhe nga aspekti i evidencës kontabile të të gjitha projekteve të përfundura nga Faza II dhe Faza III e investimeve kapitale. Gjithashtu në të njëjtën mënyrë do të trajtohen edhe të gjitha projektet e përfunduara si rezultat i Memorandumeve të bashkëpunimit me komunat në zonën e shërbimit, komunitetin si dhe donatorët e jashtëm (CDI, KfW, CDF, USAID etj), e të cilat deri më tani nuk janë trajtuar nga aspekti i kontabilitetit.

Politika tarifore siguron mbulimin e shpenzimeve operative dhe të një vlere domethënëse për investime kapitale (vetëm vetanake). Meqenëse për shkaqe të shpjeguara në këtë dokument, kjo gjë nuk është e mundur andaj implikimi i fondeve nga grantet, donacionet dhe fondeve të komunitetit është i një rëndësie të vecantë, mbase edhe i domosdoshëm.

Vlera e investimeve për vitet që i referohet ky Plan i Biznesit, nën parasupozimet e përmbushjes së parametrave të këtij, priten të jenë: Gjatë vitit 2018 do të bëhen investime në vlerë prej 1.324.000 €. Në mënyrë të specifikuar dhe detalisht janë paraqitur në listën e bashkëngjitur.

Në këtë fazë ndërmarrja nuk ka siguruar informacione shtesë dhe të besueshme për investimet që në zonën e shërbimit do të kryhen nga buxheti i shtetit, buxhetet e komunave, grantet e donatorëve dhe komuniteti. Pjesë përbërëse janë edhe shpjegimet shtesë dhe arsyetimi i implementimit të cdo projekti veçmas.

Gjatë vitit 2019 investimet kapitale do të jenë në vlerë prej 1.694.000 €. Në mënyrë të specifikuar dhe detalisht janë paraqitur në listën e bashkëngjitur. Në këtë fazë ndërmarrja nuk ka siguruar informacione shtesë dhe të besueshme për investimet që në zonën e shërbimit do të kryhen nga buxheti i shtetit, buxhetet e komunave, grantet e donatorëve dhe komuniteti.

Gjatë vitit 2020 investime kapitale të ndërmarrjes do të arrijnë vlerën prej 1.959.000 €. Në mënyrë të specifikuar dhe detalisht janë paraqitur në listën e bashkëngjitur. Në këtë fazë ndërmarrja nuk ka siguruar informacione shtesë dhe të besueshme për investimet që në zonën e shërbimit do të kryhen nga buxheti i shtetit, buxhetet e komunave, grantet e donatorëve dhe komuniteti.

Gjatë periudhës së këtij Plani të Biznesit 2018- 2020, do të realizohen investime kapitale në vlerë kumulative prej 4.977.000 €.

6.9.Lista e investimeve kapitale 2018-2020

Niveli i fondeve të nevojshme për financimin e investimeve kapitale do të jetë gjithnjë më i madh për aq sa kompania do të jetë e përgjegjshme për të shtuar sasinë e ujit që distribuon drejt konsumatorëve, rritjen e normës së ujit të faturuar, rritjen e normës së arkëtimit të shërbimeve dhe kufizimin e ngritjes së shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes.

Prandaj mbi këto premisa konstatojmë se Plani i investimeve kapitale është pjesa më e rëndësishme e këtij Plani të Biznesit. Sigurojmë se niveli i kënaqshëm i investimeve kapitale në

infrastrukturë dhe joinfrastrukturë është përfshirë e gjithë zona e shërbimit me synimin parësor ruajtja e substancës fizike të kompanisë. Përmes realizimit me sukses dhe të plotë të këtyre investimeve bëhet e mundur që KRU “Prishtina “ sh.a. të bëjë përmirësimin e shërbimeve për konsumatorë duke rritë nivelin e kënaqësisë e që do të inkurajojë konsumatorët që t’i paguajnë faturat.

Megjithatë për mbajtjen e nivelit të investimeve nuk janë të mjaftueshme vetëm fondet e brendëshme sepse ekziston një numër i projekteve të mëdha të cilat kërkojnë financim të jashtëm gjithashtu edhe vlerësim të detajuar për mënyrën e qasjes më komplekse.

Lista e investimeve kapitale 2018 – 2020

Nr	Emërtimi i projekteve	Mënyra e financimit	Inicimi i procedures	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Totali 2018-2020
1	Ndërrimi dhe ndërtimi i rrjetit të ujit për përmirësimin e furnizimit dhe zvoglimin e humbjeve në zonën e shërbimit të KRU "Prishtina" (Prishtinë, Lipjan, Podujevë, Obiliq, Shtime, Fushë Kosovë, Graçanicë dhe Drenas)	a.Fondet e ndërmarrjes	Maj	250,000	250,000	100,000	600,000
		b.Grantet e donatorëve					-
		I.Totali		250,000	250,000	100,000	600,000
2	Punimi i pusetave zonale, furnizimet dhe instalimet e fittingjeve, valvolave për rregullim presioni në zonën e shërbimit të KRU "Prishtina" (Prishtinë, Lipjan, Podujevë, Obiliq, Shtime, Fushë Kosovë, Graçanicë, Drenas)	a.Fondet e ndërmarrjes	Prill	70,000	100,000	150,000	320,000
		b.Grantet e donatorëve		-	-	-	-
		I.Totali		70,000	100,000	150,000	320,000
3	Hapja e puseve të reja në zonën e shërbimit të KRU "Prishtina" (Prishtinë, Lipjan, Podujevë, Obiliq, Shtime, Fushë Kosovë, Graçanicë, Drenas)	a.Fondet e ndërmarrjes	Prill	10,000	12,000	15,000	37,000
		b.Grantet e donatorëve		-	-	-	-
		I.Totali		10,000	12,000	15,000	37,000
4	Furnizimi dhe montimi me elektromotor për SUPER SOR në Albanik ... Furnizimi dhe montimi I elektromotorëve dhe pompave ne SP Batllave (2019-2020)	a.Fondet e ndërmarrjes	Mars	30,000	80,000	80,000	190,000
		b.Grantet e donatorëve		-	-	-	-
		I.Totali		30,000	80,000	80,000	190,000
5	Ndërtimi i rezervuarit - Mirëdita IV (2 x 1500m3)	a.Fondet e ndërmarrjes		-	-	500,000	500,000
		b.Grantet e donatorëve		-	-	-	-
		I.Totali		-	-	500,000	500,000
6	Furnizimi me ujëmatës të profileve të ndryshme për ndërrim të vazhdueshëm të ujëmatësve që prishen	a.Fondet e ndërmarrjes	Janar	10,000	40,000	40,000	90,000
		b.Grantet e donatorëve		-	-	-	-
		I.Totali		10,000	40,000	40,000	90,000
7	Furnizimi me ujëmatës SMART të profileve Fi 1/2 deri 2" për instalim të Bizneset në zonën e Prishtinës	a.Fondet e ndërmarrjes	Shkurt	130,000	150,000	200,000	480,000
		b.Grantet e donatorëve		-	-	-	-
		I.Totali		130,000	150,000	200,000	480,000
8	Furnizimi dhe instalimi i ujëmatësve zonal në zonën e shërbimit të KRU "Prishtina" sh.a.	a.Fondet e ndërmarrjes		-	150,000	150,000	300,000
		b.Grantet e donatorëve		-	-	-	-
		I.Totali		-	150,000	150,000	300,000
9	Furnizimi me pompa centrifugale horizontale, vertikale + zhytese dhe paisje (FREKUENTOR) pompat ne KRU P	a.Fondet e ndërmarrjes	Maj	50,000	60,000	70,000	180,000
		b.Grantet e donatorëve		-	-	-	-
		I.Totali		50,000	60,000	70,000	180,000

10	Furnizimi dhe montimi i valvulave të ajrit dhe valvula të presionit	a.Fondet e ndërmarrjes	Qershor	25,000	30,000	35,000	90,000
		b.Grantet e donatorëve		-	-	-	-
		I.Totali		25,000	30,000	35,000	90,000
11	Ndërimi i trasesë së rrugës së stacionit të pompave në Konjuh, shtrimi i rrugës me zhavor (rruga aktuale kalon në prona private sepse na është pamundësuar qasja në stacion të pompave).	a.Fondet e ndërmarrjes	Qershor	10,000	5,000		15,000
		b.Grantet e donatorëve		-	-	-	-
		I.Totali		10,000	5,000	-	15,000
12	Rehabilitimi dhe Ndërtimi I sistemit te klorimit të lengët dhe te gazët në objektet përcjellëse në KRU "Prishtina" sh.a.	a.Fondet e ndërmarrjes	Tetor	50,000	60,000	50,000	160,000
		b.Grantet e donatorëve		-	-	-	-
		I.Totali		50,000	60,000	50,000	160,000
13	Rehabilitimi i rezervuarit 1500m³, te Pishat në Podujevë	a.Fondet e ndërmarrjes		-	25,000	-	25,000
		b.Grantet e donatorëve		-	-	-	-
		I.Totali		-	25,000	-	25,000
14	Ndërtimi dhe riparimi i pusetave të ujësjellësit dhe kanalizimit	a.Fondet e ndërmarrjes	Prill	30,000	35,000	35,000	100,000
		b.Grantet e donatorëve		-	-	-	-
		I.Totali		30,000	35,000	35,000	100,000
15	Furnizim me material makinerik, kushineta, valvola etj.	a.Fondet e ndërmarrjes	Mars	15,000	22,000	25,000	62,000
		b.Grantet e donatorëve		-	-	-	-
		I.Totali		15,000	22,000	25,000	62,000
16	Furnizim me material elektrik	a.Fondet e ndërmarrjes	Janar	10,000	25,000	25,000	60,000
		b.Grantet e donatorëve		-	-	-	-
		I.Totali		10,000	25,000	25,000	60,000
17	Furnizim me material, tuba, fittingje dhe armatura	a.Fondet e ndërmarrjes	Shkurt	90,000	100,000	110,000	300,000
		b.Grantet e donatorëve		-	-	-	-
		I.Totali		90,000	100,000	110,000	300,000
18	Funizimi me PC- vork station për SIGJ	a.Fondet e ndërmarrjes	Shkurt	-	20,000	20,000	40,000
		b.Grantet e donatorëve		-	-	-	-
		I.Totali		-	20,000	20,000	40,000
19	Krijimi i të dhënave për menaxhimin e aseteve dhe produktit	a.Fondet e ndërmarrjes	Nentor	30,000	50,000	50,000	130,000
		b.Grantet e donatorëve		-	-	-	-
		I.Totali		30,000	50,000	50,000	130,000
20	Incizimi i rrjetës së kanalizimit	a.Fondet e ndërmarrjes		-	50,000	50,000	100,000
		b.Grantet e donatorëve		-	-	-	-
		I.Totali		-	50,000	50,000	100,000
21	Mirëmbajtja e aplikacioneve të Arc	a.Fondet e ndërmarrjes	Gusht	10,000	10,000	10,000	30,000

